



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA MBLEDHJA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 27.10.2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
27.10.2011. GODINE**

**TETOR-OKTOBAR
2011**

E enjte, më 27.10. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,
I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Në mbledhje janë të pranishëm 90 deputetë, andaj fillojmë me punimet e mbledhjes plenare, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

1. Interpelancë e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, zotit Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka parashtruar kërkesën për të ftuar në interpelancë Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë.

Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta.

Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë për çështje të shtruar të interpelancës në kohëzgjatje 15 minuta. Koha mbi 15 minuta për kryeministrin dhe mbi 10 minuta për parashtruesin, llogaritet në kohën e grupeve parlamentare.

Koha e ndarjes sipas grupeve parlamentare është kështu: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, i ka 42 minuta kohë, Lidhja Demokratike - 40 minuta, “Vetëvendosja” - 18 minuta, Grupi Parlamentar i AAK-së - 18 minuta, Grupi Parlamentar Kosova e Re - 11 minuta, Grupi Parlamentar i SLS-së - 15 minuta, Grupi Parlamentar “6+” - 7 minuta dhe deputetët pa grupe parlamentare - deri në 2 minuta.

Ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që ta marrë fjalën. Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të gjithë ata që e kanë përkrahur ndërhyrjen e Qeverisë së Kosovës në veriun e vendit më 25 korrik, për shtënien nën kontroll të dy pikave doganore, kanë menduar se Qeveria më në fund u mbush mend dhe se po e bën atë që do të duhej ta kishte bërë qyshkur. Por, tre muaj kanë kaluar që prej asaj dite dhe gjithçka që ka ndodhur më pas, ka treguar se Qeveria nuk e kishte për sovranitet, por për negociata.

Së pari, në vend që Qeveria t'i mbante nën kontroll rrugët dhe pikat doganore, ashtu që pastaj ta shtonte kontrollin dhe ta konsolidonte praninë e mekanizmave dhe institucioneve të sigurisë në veri, ajo dha urdhër për tërheqje. Pikat doganore mbetën të pambrojtura nën kujdesin e vetëm 2-3 automjeteve të policisë sonë dhe po aq automjeteve të EULEX-it, të cilat më 26 korrik u gjendën nën sulmin e bandave kriminale të dirigjuara nga Beogradi. Mbi 100 banditë të udhëhequr nga bashkënegociatori i Edita Tahirit, Borislav Stefanović, me maska, kryesisht me armë të lehta dhe koktej molotovi në duar, dogjën dhe shkatërruan tërësisht pikat doganore të Kosovës. Kjo është djegia e dytë e kufijve tanë pas vitit 1999, - e para menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, kurse kjo e fundit, më 26 korrik 2011. Në të dyja rastet, kryeministër i vendit ishte Hashim Thaçi.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, unë ju pyes juve - çfarë shteti paskemi ndërtuar në këtu në Kosovë, i cili, sipas Qeverisë, nuk paska kapacitete të mjaftueshme institucionale dhe të sigurisë për t'i neutralizuar 100 banditë të strukturave paralele? Jo, zotërinj, nuk është puna këtu te kapacitetet e shtetit të Kosovës, por te vullneti i pushtetit politik të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Prej 26 korrikut, veriu është lënë i tëri nën mëshirën e Beogradit dhe strukturave kriminale të Serbisë. Dhjetëra barrikada janë ngritur gjithandej rrugëve kryesore të veriut. Por tash, që u krijua kjo situatë, Qeveria po merret me veriun nga Prishtina, me konferenca shtypi dhe po mburret me veprimet e zakonshme të KFOR-it. Kurse tash gjendja është kjo: Prishtina nuk është atje, kurse strukturat kriminale kanë marrë kompetencat e KFOR-it në duar, e të cilat po vendosin se kush mund ta ushtrojë të drejtën e lëvizjes e kush jo përbrenda territorit të Republikës së Kosovës.

Në kemi thirr kryeministrin në interpelancë, i cili duhet të japë llogari, sipas mendimit tonë, në 7 pika, të cilat janë dorëzuar paraprakisht. Më 25 korrik, me vendim të Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në pjesën veriore të Kosovës u dërguan njësitë speciale të Policisë së Kosovës me qëllim të vënies nën kontroll të pikave doganore 1 dhe 31, në Bërnjak dhe Jarinje. Kjo ndërhyrje krijoi një situatë të re politike dhe të sigurisë në atë pjesë të Republikës së Kosovës.

Sipas vetë zotit Thaçi, ky intervenim është bërë drejtpërdrejt me urdhër të tij dhe është organizuar nën autoritetin e tij. Por, ai është bërë pa u konsultuar Kuvendi i Republikës së Kosovës, pa bashkëveprim ndërministror e qeveritar, pa u informuar qytetarët e Kosovës, pa bisedim me të gjitha subjektet parlamentare paraprakisht, si dhe siç u pa pastaj, pa bashkërendim edhe me faktorët ndërkombëtarë. Të zgjedhurit e popullit kanë nevojë që të jenë më hollësisht të informuar për planifikimin e aksionit dhe rrjedhjen e tij.

Pas ndërhyrjes së 25 korrikut dhe vendosjes së doganierëve në pikat 1 dhe 31, u tërhoqën njësitë speciale të policisë, prandaj doganierët mbetën pa mbrojtje dhe siguri të mjaftueshme. Gjatë tërheqjes nga strukturat e paligjshme armiqësore të Serbisë, të armatosura dhe kriminale, u vra polici i Republikës së Kosovës, si dhe Heroi i Kosovës, Enver Zymberi. Deputetët dhe qytetarët kanë nevojë ta dinë pse u mor vendimi për tërheqjen e forcave policore nga pjesa veriore e Kosovës.

Pas tërheqjes së forcave të Policisë së Kosovës, grupe të armatosura serbe, nën udhëheqjen edhe të shefit të delegacionit serb në negociata me Kosovën, Borislav Stefanović, sulmuan pikat doganore 1 dhe 31. Ata i dogjën kufijtë e pambrojtur të Kosovës.

Grupe të armatosura të strukturave kriminale të Serbisë kanë bllokuar tash rrugët kryesore të kësaj pjese të Republikës së Kosovës duke vënë barrikada. Qeveria e Kosovës dhe segmentet shtetërore të sigurisë nuk janë të pranishme në këtë pjesë të Kosovës. Qytetarët dhe deputetët duhet të informohen se cili është plani i Qeverisë për zhblokimin e kësaj pjese të territorit të Kosovës.

Mbi 4.000 qytetarë shqiptarë që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, për shkak të pranisë simbolike të mekanizmave shtetëror të sigurisë në atë anë, mbeten të pambrojtur dhe ndjehen të pasigurt nga strukturat e armatosura të Beogradit. Qeveria duhet ta sqarojë strategjinë e saj për mbrojtjen e tyre. Kryeministri, po ashtu, duhet t'i shpjegojë deklaratat e përgjegjshme të ministrit të Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, i cili ka thënë se atyre shqiptarëve që frikësohen në pjesën veriore të Kosovës “duhet t'u shkruhet hajmali”. Pyetja është, a është ky edhe mendim i Qeverisë apo vetëm personal i ministrit Rexhepi?

Menjëherë pas ndërhyrjes së rrufeshme në pjesën veriore, si dhe tërheqjes po aq të shpejtë, kjo pjesë e Kosovës është barrikaduar. Por është me rëndësi të vërehet se si nuk kaluan shumë ditë dhe filluan kërkesat ndërkombëtare për një dialog politik mes Kosovës dhe Serbisë, ku do të flitej edhe për veriun. Kryeministri Thaçi ka thënë se është i gatshëm të takohet me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, ku do të flitej për problemet politike. Zyrat e huaja kanë filluar të flasin, po ashtu, për një zgjidhje politike për veriun e Kosovës.

Por për shkak të peshës së problemit të veriut edhe në aspektin historik, është me rëndësi që kryeministri të japë përgjegjësi jo vetëm për këta tre muajt e fundit, por edhe aty kur realisht ka filluar problemi i veriut, e ky është viti 1999, qershori i vitit 1999.

Çështjet në të cilat ai duhet të japë përgjegjësi, janë këto:

- A ka pasur ndonjëherë marrëveshje të veçantë, të shkruar apo gjentëllmene, çfarëdo qoftë ajo, me faktorin ndërkombëtar për veriun e Kosovës që prej vitit 1999?

- Tjetër, kush dha urdhër nga strukturat e larta të UÇK-së, më 1999, që të tërhiqen njësitë e UÇK-së nga veriu i Kosovës?

Komandanti në zonën e Shalës, Bekim Shyti, në një konferencë publike në vitin 2005 ka thënë se personalisht atij i ka ardhur urdhri nga Shtabi i Përgjithshëm, përderisa forcat serbe tërhiqeshin, kurse ai i udhëhiqte ushtarët në fshatrat e veriut Gushavc e Vinarc. Popullit i intereson, kush e ka dhënë këtë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që forcat tona të tërhiqen prej veriut?

Ju keni qenë më pas edhe kryeministër i Qeverisë së përkohshme. A keni pasur marrëveshje me UNMIK-un që të mos preken kurrë strukturat e Serbisë në veri, apo këtë e keni bërë siç keni dashur vetë?

Kjo perspektivë historike ka rëndësi të madhe sepse kjo gjë prej vitit 1999 e deri më sot, sa i përket veriut dhe të gjithat që kanë ndodhur me veriun, lidhet me figurën e Hashim Thaçit. Më 1999 ka qenë tërheqja e parë fatale e forcave të UÇK-së nga veriu me urdhër politik. Më pas u çarmatos e u shkatërrua UÇK-ja, kurse më 26 korrik 2011, pra 12 vjet më pas, sërish u tërhoqën forcat e Policisë së Kosovës nga veriu dhe kjo pjesë e Kosovës sërish po sundohet nga strukturat kriminale të Beogradit. Në të tria këto ngjarje, kryeministër ka qenë Hashim Thaçi. Shtrohet pyetja – pse Kryeministri Thaçi me këto tërheqje të vazhdueshme sillet sikur të ketë bërë marrëveshje me dikë, ashtu që të gjitha veprimet e tij për veriun janë improvizime, të cilat nuk guxojnë ta kalojnë një vi të kuqe. Kush e ka vendosur këtë vi të kuqe dhe kush me kë është marrë vesh – këto janë pyetjet tona dhe çështjet që i ngritëm dhe ne kërkojmë përgjigje, e në fund do ta parashtrojmë edhe mocionin tonë prej 4 pikash, të cilat shpresojmë se do të votohen Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ftoj kryeministrin që ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar, zoti Krasniqi!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritarë, Qeveri e Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht, më lejoni të theksoj se e mirëpres kërkesën për interpelancë parlamentare për çështjen e situatës politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës.

Unë dua të besoj se kërkesa për interpelancë është bërë me qëllimin më të mirë, që të diskutohet për situatën në veri të vendit, në mënyrë që të forcohet edhe më shumë uniteti i gjithë spektrit politik të Kosovës, pozitë dhe opozitë, për hapat vendimtar që po ndërmerr Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim të plotë me NATO-n, EULEX-in, Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vendosjen e sundimit të rëndit dhe ligjit në atë pjesë të territorit tonë.

Në këtë drejtim, unë mirëpres çdo ide tuajën edhe sot, idetë e dobishme që i shërbejnë këtij qëllimi madhor, e që për mua është prioritet mbi prioritete, është përgjegjësi shtetërore dhe jo debat me motive elektorale.

Natyrisht, se sot nuk është hera e parë që ne po diskutojmë për çështjen e cila që nga fillimi i qeverisjes sime ka qenë prioriteti kryesor në agjendën e Qeverisë së Kosovës dhe ky rast mua më jep mundësinë që këtu para jush të paraqesim angazhimet dhe punën tonë të deritashme, si dhe sfidat në shtrirjen e sundimit të ligjit dhe integrimin e gjithë territorit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të gjithë e dimë që situata në veriun e Kosovës nuk është krijuar tani, as para tri viteve. Situata në veri të Kosovës është trashëguar që nga përfundimi i luftës tonë çlirimtare dhe vendosja e administrimit ndërkombëtar të UNMIK-ut në Kosovë.

Ne të gjithë i dimë dhe ende i kemi të freskëta veprimet gjenocidiale të Serbisë dhe politikën e saj të spastrimit etnik ndaj Kosovës.

Fatkeqësisht, kjo politikë e shekullit të kaluar ende përdoret nga Serbia në relacion me Kosovën, por tani në një formë të kamufluar për shkak të përpjekjes për të mashtruar komunitetin ndërkombëtar për veprimet e saja kriminale në Kosovë.

Pas vitit 1999, megjithëse Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë kishte përgjegjësinë në bazë të Rezolutës 1244 për vendosjen e rendit dhe ligjit edhe në pjesën veriore të Kosovës, UNMIK nuk e bëri një gjë të tillë dhe situata atje është përcjellë nga një kaos total, ndërsa politika e administrimit ndërkombëtar të OKB-së ka pasur qasje të ndara dhe të ndryshme të administrimit të Kosovës veriore dhe të pjesës tjetër të Kosovës.

Duke shkelur mandatin e vet dhe duke vepruar në një formë jo transparente, Administrata e UNMIK-ut në veri të Mitrovicës ka ndihmuar në ndarjen de facto ndërmjet serbëve dhe bashkësive të tjera etnike që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës.

Kështu, duke lejuar pa pengesë veprimtarinë ilegale të strukturave paralele, Administrata e UNMIK-ut atje në formë direkte ose indirekte ka ndihmuar strategjinë e Beogradit në vendosjen e strukturave për kontrollimin e territorit në pjesën veriore të Kosovës dhe kështu ka shkelur integritetin territorial të Kosovës, por edhe vet Rezolutën 1244.

Trashëgimia e rëndë e luftës, vazhdimi i dhunës ndëretnike në veri, incidentet e ndryshme dhe të vazhdueshme që nga 1999, 2004, 2007, veprimi i organizatave ekstreme si rojat e urës, pjesëtarët e MUP-it, të Mbrojtjes Civile Serbe, BIA-a, grupet e shumta kriminale që kontrollojnë krimin e organizuar dhe kontrabandën, kanë krijuar një situatë të mungesës së vazhdueshme të rendit dhe ligjit si dhe jetës së ndarë në qytetin e Mitrovicës dhe në komunat tjera të banuara me shumicë serbe në veri të Mitrovicës.

Tolerimi i funksionimit të pjesshëm të pikave kufitare 1 dhe 31, mosfunksionimi i gjykatave në veri, krijimi i monopoleve ekonomike të qendrave të krimit të organizuara dhe përkrahja e këtyre strukturave nga ana e Beogradit kanë krijuar situatën e tanishme në veri të Kosovës, deri më 25 korrik të këtij viti.

Unë sot nuk dua të drejtoj gishtin për të fajësuar qeveritë e mëparshme, të cilat nuk kanë bërë pothuajse asgjë për ta ndryshuar gjendjen e rëndë të krijuar në veri të vendit. Nuk dua të bëj një gjë të tillë sepse mendoj se sot është koha që ne jemi të bashkuar si kurrë më parë, me qëllimin tonë legjitim për ruajtjen e tërësisë territoriale të Kosovës dhe vendosjen e sundimit të rendit dhe ligjit.

Mirëpo, duhet pranuar se një gjendje e tillë e akumuluar me vite, si dhe shpallja e

pavarësisë së Republikës së Kosovës ka nxitur reagimin edhe më të madh dhe të planifikuar të ekstremisteve serbë, duke djegur pikat kufitare, shtimin e kriminalitetit dhe sfidimin e sundimit të ligjit në atë pjesë të Kosovës.

Përveç këtyre faktorëve, gjendjen e ka vështirësuar edhe qëndrimi jo i qartë apo neutral ndaj Pavarësisë së Kosovës i disa misionëve ndërkombëtare që kanë vepruar dhe janë duke vepruar në Kosovë.

Megjithatë, përpjekjet dhe aktivitetet e Qeverisë në drejtim të ndryshimit të situatës dhe integritetit të këtij territori kanë qenë të vazhdueshme.

Me këtë rast, konsideroj se gjendjen në veri të Kosovës dhe angazhimet e institucioneve mund t'i ndajmë në tri periudha:

1. Periudha deri në vitin 2008, pra deri me shpalljen e Pavarësisë, e cila u përshkrua nga mungesa totale e sundimit të ligjit dhe rendit në atë pjesë të Kosovës dhe mungesa e iniciativës dhe përpjekjeve të institucioneve të nivelit qendror për të shtrirë sovranitetin.
2. Periudha që nga shpallja e pavarësisë deri me 25 korrik 2011, dhe
3. Periudha pas 25 korrikut 2011 dhe deri më tani.

Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, si dhe reagimin ndaj kësaj, dihet se kishte aktivitete të shtuara të grupeve kriminale dhe të strukturave paralele, të cilat në fillim rezultuan me djegien e pikave kufitare, ndërprerjen e funksionimit të gjykatës në veri dhe thellimit dhe rritjes së aktiviteteve kriminale dhe strukturave paralele në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Këto aktivitete ishin po ashtu të përqendruara në presion ndaj popullatës shqiptare që jeton në atë pjesë për të lëshuar vendbanimet e tyre.

Ndërsa, në anën tjetër, ne si Qeveri për herë të parë filluam programet e investimeve të shtetit të Kosovës për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve tanë në atë pjesë për të krijuar kushte afatgjata për sundim të ligjit dhe luftim të kriminalitetit.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'iu rikujtoj se qytetarët e pjesës veriore të Kosovës për herë të parë e kanë ndier ndihmën e dorës së shtetit të Kosovës pas vitit 2008.

Ndihma për këta qytetarë nuk ka qenë e pakët. Qeveria gjatë kësaj periudhe ka investuar me miliona euro në infrastrukturë rrugore, rindërtim të shtëpive dhe ofrim sa më të mirë të shërbimeve ndaj të gjithë qytetarëve tanë të asaj pjese.

Si rezultat, vetëm pas vitit 2008 kemi fillimin e kthimit të banorëve shqiptarë në shtëpitë tyre të rindërtuara në pjesën veriorë të Kosovës.

Po ashtu, qasja e Qeverisë ka qenë në drejtim që qytetarët serbë në atë pjesë të Kosovës të pranojnë përpjekjet tona si një mundësi për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe standardit të jetesës së tyre.

Siç e dini, angazhimet e Qeverisë në veri janë zbatuar përmes një kornize strategjike dhe të planifikuar mirë, si dhe të koordinuar me strukturat përgjegjëse ndërkombëtare, KFOR-in dhe EULEX-in.

Strategjia për veriu ishte një përkushtim i Qeverisë së Kosovës për vendosjen e rendit dhe ligjit në pjesën veriore të Kosovës. Nuk ka dyshim se të gjitha institucionet e Kosovës kanë qenë të angazhuara për zbatimin e ligjit dhe zhbërjen e strukturave paralele dhe grupeve kriminale.

Në kuadër të veprimeve tona, ne kemi emëruar koordinatorin për zbatimin e Strategjisë së veriut, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kemi hapur Zyrën për Regjistrim Civil dhe kemi vazhduar investimet, si dhe rindërtimin e shtëpive për të kthyerit në pronat e tyre, ashtu edhe në sektorë të tjerë kemi vazhduar me investime.

Në sektorin e Bujqësisë është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Bujqësisë për të ndihmuar qytetarët e asaj ane me subvencione të ndryshme për punimin e tokave bujqësore.

Të nderuar deputetë,

Kthesa vendimtare për lëvizjen nga status quoja për situatën në veri të Kosovës, me plot bindje e them se ka qenë vendimi i 25 korrikut.

Vendimi për ndërhyrje për vënien në kontroll të pikave kufitare 1 dhe 31 nga ana e Policisë së Kosovës ka qenë një vendim i menduar mirë, i planifikuar dhe i koordinuar shumë mirë. Ky vendim dhe veprim nuk ka qenë i lehtë, por ka qenë vendim i drejte dhe i domosdoshëm.

E dini mjaft mirë se ai vendim ka sjellë edhe rezultatet e veta, ndërsa rezultati përfundimtar pa dyshim do të jetë integrimi i asaj pjese të Kosovës dhe vendosja përfundimtare e rendit dhe ligjit në pjesën veriore të Kosovës.

Prandaj, më lejoni që këtu para jush të paraqes situatën që ka shpjerë drejt 25 korrikut dhe pas 25 korrikut.

Siç edhe ju kam informuar në paraqitjet e mia të mëhershme para Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, 25 korriku ka qenë një vendim i domosdoshëm, i drejtë dhe sovran i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky vendim është marrë në koordinim të plotë me të gjitha strukturat e sigurisë në Republikën e Kosovës, qofshin ato struktura vendore, por në një masë të konsideruar, edhe ato ndërkombëtare.

Ky vendim ishte vendim sovran i Qeverisë së Kosovës, nëse dikush dëshiron që ta personalizoj, le ta personalizojë. Unë jam kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe e udhëheq Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Normalisht, si në çdo vend demokratik të pavarur dhe sovran, barra kryesore e vendimmarrjes dhe metodologjia e zbatimit të vendimit bie tek ata që qytetarët e Kosovës dhe Kuvendit i Kosovës iu kanë dhënë besimin për të qeverisur me vendin, pra tek Qeveria e Republikës së Kosovës.

Secili vend demokratik do të vepronte në mënyrën siç kemi vepruar edhe ne. Prandaj, më lejoni të paraqes disa arsye kryesore të marrjes së këtij vendimi:

- Kontrabanda masive dhe zhvillimi i krimit të organizuar në këtë pjesë të territorit të Kosovës dhe përmes kësaj pjese në pjesën tjetër të territorit të Kosovës.

Kosova që nga çlirimi i saj dhe në kohën e administrimit ndërkombëtar, kurrë nuk e pasur nën kontroll pjesën veriore të Kosovës. Kontrollin në atë pjesë e kanë bërë strukturat kriminale, shpesh të ndihmuara dhe përkrahur nga shteti Serb.

Si rezultat, në 12 vitet e fundit në atë pjesë ka lulëzuar kontrabanda dhe krimi i organizuar, duke i shkaktuar shtetit të Kosovës humbje dhe dëm në fusha të ndryshme në shumë aspekte. Shteti i Kosovës vetëm për një vit, si rezultat kontrabandës ka humbur të ardhura deri në 150 milion €.

Zhvillimi i kontrabandës në këtë pjesë, si dhe ndikimi edhe në pjesët tjera të Kosovës, jo vetëm që ndikon në ngecjen e zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe në ngecje në plotësimin e standardeve evropiane, për të cilat jemi të obliguar nga ana e kriterëve për t'i zbatuar kriteret në procesin e integritetit evropian.

Zhvillimi i kësaj dukurie ka ndikuar edhe në zhvillimin e aktiviteteve tjera kriminale nga ana e grupeve të organizuara dhe të mbështetura nga shteti serb.

Rritja e krimit të organizuar. E gjithë kjo kontrabandë është kryer nga grupe kriminale dhe ka ndikuar në rritjen e tyre kriminale në pjesën veriore të Kosovës.

Lulëzimi i krimit dhe arritja e një vetëdije të paprekshmërisë ka ndikuar në mbajtjen peng të mbi 40 mijë qytetarëve serbë të Kosovës, pa marrë parasysh etnicitetin e tyre, peng të dëshirave dhe urdhrave të këtyre grupeve kriminale, kështu është penguar jeta normale e qytetarëve.

Këta qytetarë kanë jetuar në frike dhe agoni nga këto struktura, prandaj ne vlerësojmë se ka qenë dhe mbetet obligim jo vetëm i Qeverisë së Kosovës, por i gjithë spektrit përfaqësues në Kosovë që këta qytetarë të lirohen nga frika dhe agonia e jetës së krijuar atje nga krimi dhe bandat e organizuara.

Për më shumë, këta kriminelë janë duke u përpjekur për të sfiduar shtrirjen e kushtetutshmërisë dhe sovranitetit në të gjithë territorin e Kosovës, duke pasur ndikim negative në synimet tona nacionale për integritet euro-atlantike.

Prandaj, edhe ka lindur nevoja e ndërmarrjes së masave për vendosjen e rendit dhe të ligjit në këtë pjesë të Kosovës. Unë dua t'ju siguroj që ky është fillimi pasi që vendosja e rendit dhe ligjit është proces i vazhdueshëm dhe ne do të jemi të palëkundur në synimet tona.

Vendosja e masave të reciprocitetit. Këtu më lejoni që të theksoj edhe njëherë sa i për këtë çështje së dialogut, se u hapën çështje të ndryshme edhe sa i përket veriut, edhe dialogut, u dëgjuan edhe akuza dhe mllefe të ndryshme.

Dëshiroj të theksoj edhe njëherë, dialogu mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë është rezultat i obligimeve ndërkombëtare që ka pranuar ky Kuvend i Kosovës, koalicioni i mandatit të para katër viteve, është një obligim ndërkombëtar të cilin e kemi pranuar të gjithë në Kuvendin e Kosovës.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës vetëm zbaton vendimet e Kuvendit të Kosovës dhe gjithë ky angazhim dhe përkushtim i Qeverisë së Kosovës për dialog mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë për çështje teknike, është një përgjegjësi për implementimin e modeleve evropiane për çështjet teknike ndërshtetërore, diçka që ne e kemi bërë edhe me Maqedoninë, edhe me Shqipërinë, por në të njëjtën kohë edhe me Malin e Zi. Do të vazhdohet të ketë takime tjera në të ardhmen sa i përket telekomunikacionit, sa i përket energjisë, marrëdhënieve regjionale, si dhe çështjeve tjera gjyqësore dhe do të përmbyllet me njohje reciproke mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Ne kemi qenë dhe do të vazhdojmë të jemi të zotuar që të ndërtojmë fqinjësi të mirë me të gjitha vendet e rajonit, si parakusht i domosdoshëm për t'u integruar edhe në NATO, por edhe në Bashkimin Evropian.

Pra, vendosja e masave të reciprocitetit që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, shteti Serb ka vendosur njëanshëm sanksione kundër shtetit të Kosovës, me theks të veçantë në produktet e Kosovës.

Këto sanksione kanë qenë në kundërshtim të plotë me marrëveshjen CEFTA. Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar në Kosovë dhe jashtë Kosovës, ka pranuar dialogun teknik me Serbinë.

Ky dialog, siç edhe e kam deklaruar, vjen si obligim ndërkombëtar dhe si nevojë për të përshpejtuar procesin e integritet evropian.

Përkundër përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare të Kosovës dhe konstruktivitetit tonë në bashkëpunim rajonal dhe dialog teknik me Serbinë, Serbia nuk hoqi dorë nga sanksionet e vendosura kundër Kosovës.

Për më tepër, pavarësisht konkluzave të Bashkimit Evropian për disa aspekte të arritura në Bruksel, si pjesë e dialogut, Serbia u tërhoq nga vazhdimi i dialogut kur u vendos të diskutohet për çështjen e vulave doganore apo implementimin e tyre.

Kjo sjellje e vazhdueshme destruktive e Serbisë nuk i la rrugëdalje tjetër Kosovës, pos të vendosë masa reciproke ndaj produkteve serbe. Por, për të vendosur këto masa, vendime të vështira është dashur të merren, në mënyrë që masat e vendosura të reciprocitetit të mund të zbatohen.

Prandaj, vendimi i marrë më 25 korrik dhe veprimet për zbatimin e këtij vendimi kanë sjellë rezultatet, ku masat e reciprocitetit janë zbatuar në plotëni dhe asnjë produkt i Serbisë nuk ka mundur të futet në Kosovë derisa vendimi i tillë ka qenë në fuqi, ndërsa rezultatet e këtij vendimi tashmë i dimë të gjithë.

Të nderuar deputetë,

Është e nevojshme që të thuhet se gjendja e krijuar në vazhdimësi në veriun e Kosovës ka pasur ndikimin negativ më së shumti mbi qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh etnicitetin e tyre. Gjendja e tillë ndikon në zhvillimin normal të shtetit të Kosovës, ndërsa direkt prek qytetarët të cilët jetojnë në atë pjesë të territorit të Kosovës. Popullata serbe e asaj pjese të Kosovës tashmë janë bërë peng e grupeve të interesave kriminale për përfitime personale.

Rreth 40 mijë qytetarë serbë, përfshirë gra dhe fëmijë, nxënës të shkollave janë bërë pre e këtyre grupeve dhe instrument i një politike të grupeve të caktuara politike e shtetërore të Beogradit.

Prandaj, po ju garantoj këtu dhe nëpërmjet Kuvendit të Kosovës, të gjithë qytetarëve të Kosovës, se masat e ndërmarra në veri nuk janë të drejtuara kundër asnjë qytetari të Kosovës, që është brenda kornizave ligjore, apo e asnjë grupi etnik në Kosovë.

Qeveria e Kosovës nuk është në konflikt me qytetarin në veri, është në konflikt me ata që kanë shkelur rendin dhe ligjin, të cilët duhet të përballen me drejtësinë. Qeveria e Kosovës është e zotuar t'ju shërbej gjithë qytetarëve, edhe në veri, për të ndryshuar jetën e tyre për të mirë. Të gjitha masat e ndërmarra janë në dobi të qytetarëve të Kosovës që duan të jetojnë lirshëm dhe në mënyrë të ndershme në përputhje me rendin kushtetues. Ndërsa, këto masa dhe të tjerat që do të ndërmerren, do ta ngushtojnë gjithnjë e më shumë hapësirën e veprimit për strukturat e krimit të organizuar, strukturat ilegale serbe që veprojnë në veri të Kosovës. Fundi i tyre nuk është i largët dhe ata nuk do të mund të fshihen përgjithmonë as prapa fëmijëve dhe as prapa grave të pafajshme të cilat janë nxjerrë me dhunë dhe forcë në krye të barrikadave.

Ne dimë t'i dallojmë qytetarët e ndershëm nga kriminelët, ne do t'i ndihmojmë qytetarët e zakonshëm që të ndërtojnë jetën e tyre pa frikë nga askush, që të ketë rend dhe ligj, demokraci dhe zgjedhje të lira e lidhshme legjitime, në mënyrë që Qeveria e Kosovës të investojë në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës.

Nuk do të ketë trajtim të veçantë apo të ndarë të një etniteti apo të qytetarëve pse jetojnë në pika të ndryshme apo në zona të ndryshme të territorit të Kosovës. Çdo qytetar i Kosovës do t'i gëzojë të drejtat e barabarta. Ndërsa, do të përdorim vetëm ligjin dhe drejtësinë e merituar për të gjitha strukturat ilegale e kriminale që veprojnë në veri të vendit.

Të nderuar deputetë,

Vendimi i 25 korrikut për marrjen në kontroll nga forcat e Kosovës të vijës kufitare mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë ka ndodhur për herë të parë pas 12 viteve. Ritheksoj edhe një herë, vendimi i 25 korrikut ishte vendim sovran i shtetit të Kosovës, ishte meritë e shtetit të Kosovës dhe ishte meritë e qytetarëve të Kosovës.

Ky vendim dhe veprimet e mëvonshme të institucioneve të Republikës së Kosovës, KFOR-it dhe EULEX-it kanë nxitur reagime të strukturave kriminale të cilat kanë krijuar situata e tensione politike, të manifestuara me barrikada, të vendosura nga strukturat kriminale, që po pengojnë lëvizjen e lirë dhe herë pas here natyrisht se duken edhe si incidente të armatosura.

Prandaj, operacioni për largimin e barrikadave dhe lirinë e rrugëve në veri është në kuadër të përkushtimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës për të garantuar lirinë e plotë të lëvizjes, vendosjen e rendit dhe ligjit, për të krijuar siguri, paqe, integritet dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në pjesën veriore të vendit.

Pas suksesit që nga korriku i këtij viti, është plotësisht e qartë dhe botërisht e ditur se Kosova e ka përkrahjen e plotë të botës demokratike. Vendimin sovran të institucioneve të Republikës së Kosovës, vendimin sovran të Qeverisë së Kosovës sot e përkrahin në plotëni, që të mos ketë rikthim të situatës së para 25 korrikut, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, NATO, EULEX-i dhe shtetet tjera demokratike në përpjekje të saj për rend dhe ligj.

Prandaj, më lejoni edhe njëherë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të popullit të Kosovës, të falënderoj edhe mesazhin e qartë të presidentit Obama për zhvillimet në veri, presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbështetjen e plotë të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian, mbështetjen e plotë të NATO-s, gjithashtu rolin aktiv, dinamik e pozitiv të EULEX-it tani, koordinimin e plotë që Qeveria e Republikës së Kosovës e ka me gjithë faktorët relevantë. Pra, në agjendën për rend dhe ligj, për rend demokratik, për jetë të re në veri, sot Qeveria e Kosovës e ka mbështetjen e gjithë botës demokratike.

Ky unitet veprues i Qeverisë së Kosovës, i institucioneve të Kosovës, i botës demokratike, ka ndodhur pikërisht nga konstruktiviteti i Qeverisë së Kosovës, nga përgjegjësia e plotë për t'iu shërbyer të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pa dallim etnie, në përgjegjësitë tona që kemi treguar për respektimin e plotë të standardeve evropiane, që të gjitha çështjet të zgjidhen sipas modelit dhe kritereve evropiane, që të garantojmë jetën e sigurt dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës,

për të respektuar në plotëni Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, dokumentin e presidentit Ahtisari dhe Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Dhe, të jeni të bindur se veç një unitet i tillë veprues e institucioneve legjitime e demokratike të Kosovës dhe faktorëve relevantë ndërkombëtarë të shteteve të Bashkura të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe, theksoj, për integrimin në veri, Bashkimi Evropian është unik dhe shumë i qartë. Pra, ky koordinim duhet të vazhdohet edhe në të ardhmen, edhe unë ju falënderoj të gjithëve për rolin tuaj konstruktiv. Është bërë shumë, e di që duhet bërë edhe më tepër, është kërkuar edhe nga ju që të lëvizet në mënyrë edhe më dinamike edhe më pro aktive, pajtohem plotësisht. Çdo ide e juaja do të jetë e dobishme, do të jetë e mirëpritur.

Prandaj, falënderoj edhe rolin e shumicës së opozitës për mbështetjen e plotë që i ka dhënë Qeverisë së Republikës së Kosovës. Natyrisht, e di se ndonjëherë kërkohen edhe detale në angazhime të Qeverisë së Kosovës dhe autoriteteve tjera ndërkombëtare, e theksoj edhe një herë. Ju faleminderoj shumë që edhe ju keni kërkuar për mirëkuptim që në disa çështje specifike të vazhdojmë të punojmë dhe të kemi rezultate, se sa vetëm të deklarohe mi me fjalë të thatë.

Pra, edhe një herë dëshiroj t'ju falënderoj shumë për këtë mundësi për këtë debat dhe t'ju siguroj juve dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, se nuk do të ketë kthim mbrapa në vendosjen e qetësisë, sigurisë dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, që është detyra jonë parësore kushtetuese dhe ligjore.

Për këtë, unë ju siguroj edhe një herë se nuk do të ketë në asnjë rrethanë dhe me asnjë çmim ndonjë kompromis. Por, pasi që është ngritur çështja për veriun, dëshiroj të prezantoj vetëm disa nga investimet që Qeveria e Kosovës ka bërë në veri për ndryshuar jetën e qytetarëve atje, natyrisht duke ndarë vazhdimisht mjete shtesë, qoftë për ndërtimin e shkollave të reja, ambulantave, gjithashtu ka hapur edhe zyrën e Qeverisë së Republikës së Kosovës në veri, për të ndërtuar rrugë të reja, kanalizime, ujësjellës, trotuare, kështu që mund të përmend ndërtimin e rrugës në Vinarc të Epërm, ndërtimi i rrugës Suhodollë-Vidmriq, ndërtimi i rrugës Vinarc i Poshtëm-Vinarc i Epërm, ndërtimi i rrugës Suhodollë-Kroi i Vitakut, ndërtimi i rrugës Kelmend-Boletin-Zhazhë, ndërtimi i rrugës në Lagjen e Doktorëve, ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në Lagjen e Doktorëve, ndërtimi i ujësjellësit Gushavc-Vinarc, ndërtimi i ujësjellësit në Lagjen e Doktorëve, ndërtimi i lidhjeve anësore në rrjetin e ujësjellësit në fshatin Vinarc, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Gushavc, ndërtimi i rrjetit elektrik në Lagjen e Doktorëve, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen Kroi i Vitakut, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Vinarc, Gushavc, Vidmriq, ndërtimi i ndriçimit publik në Kroin e Vitakut, ndërtimi i rrugëve në lagjen Kroi i Vitakut, ndërtimi i rrugës në fshatin Gushavc, ndërtimi dhe meremetimi i shtëpive në lagjen Kroi i Vitakut, Lagjen e Doktorëve, Lagjen "7 Shtatori", ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Koshtovë, Bistricë, Cerajë, ndërtimi i shkollës së re në Lagjen Suhodoll, ndërtimi i 13 shtëpive në Lagjen e Boshnjakëve, ndërtimi i shtatë shtëpive në Suhadoll, rindërtimi i katër shtëpive në Kodrën e Minatorëve, ndërtimi i pesë shtëpive në Lagjen e Doktorëve, sanimi i dëmeve të shkaktuara nga trazirat, pagesa e qirasë për familjet e zhvendosura nga veriu, materiali ndërtimor për ndërtimin e shtatë shtëpive, ruga e Vllahisë.

Këto janë vetëm disa nga investimet që kanë ndodhur dhe të tjerat. Ndërsa vitin e kaluar kemi ndarë pesë milion euro tjera shtesë për të investuar edhe në pjesën tjetër të komunave tjera.

Në të njëjtën kohë, kemi ndarë para dy jave edhe një milion euro shtesë dhe do të ndajmë edhe fonde tjera, në mënyrë që të investojmë në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës.

Këto fshatra dhe emrat e rrugëve që u përmenden, pasi që kishte edhe pak reagime, janë në pjesën veriore të Mitrovicës, për ata që nuk e dinë. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas Rregullores, fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kryetari Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në vazhdimësi ka treguar gatishmërinë dhe vullnetin e mirë për të debatuar në çdo kohë, me çdo kënd kur ka parë të arsyeshme dhe ka vlerësuar se është në të mirën e vendit. Kështu do të vazhdojmë edhe sot dhe në të ardhmen.

Grupi Parlamentar i PDK-së e falënderon kryeministrin e vendit për vullnetin e mirë, respektin që po tregon para institucionit vendimmarrës, Parlamentit të Kosovës, dhe gjithsesi para të zgjedhurve apo përfaqësuesve të popullit tonë.

Për veriun e Mitrovicës kemi debatuar gjerë dhe gjatë. Ky është shqetësimi më i madh dhe më i rëndë dhe më i ndjeshëm në Kosovën e pas luftës.

Prej pas lufte deri më sot janë ndërruar disa qeveri. Problemi i Mitrovicës ka qenë po ai i njëjti, i pandryshueshëm deri më 25 korrik të këtij viti, kur Qeveria e Republikës së Kosovës mori një vendim të drejtë për të vepruar.

Këtu, në këtë foltore, nga deputetët është kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të veprojë në veriun e Mitrovicës për të ushtruar ndikimin e vet për shtrirjen e sovranitetit dhe ruajtjen e tërësisë territoriale dhe, mbi të gjitha, për luftimin e krimit dhe të kontrabandës dhe të kriminelëve që ishin koncentruar në atë pjesë të territorit të Kosovës.

Pas vendimit të Qeverisë, të gjitha grupet parlamentare të Kosovës ishin unike dhe nxorën një rezolutë me të cilën i dhanë mbështetje të pa rezervë, të fuqishme Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkuam që të bashkërendojë dhe të bashkëveprojë me gjithë faktorët vendorë dhe ndërkombëtarë në vend për zgjidhjen e këtij problemi të ndjeshëm.

Rezultatet e këtij vendimi janë evidente dhe çdo qytetarë i Kosovës i sheh. Përderisa këtu ne para 25 korrikut kemi kontaktuar të gjithë se 30% e territorit të Kosovës ishte jashtë kontrollit, sot ndihemi, ky vendim na bën të ndihem mirë se territori i Kosovës sot kontrollohet nga ne.

U bëj thirrje, kolegë të nderuar, KFOR-in mos ta shohim si pjesë të huaj. KFOR-i jemi vetë ne. Ne synojmë që të aderojmë në Bashkësinë Evropiane dhe pa tjetër se do të jemi edhe pjesë e NATO-s. Ne duhet t'u gëzohemi dhe t'i mbështesim forcat e KFOR-it, të cilat po tregojnë suksese dhe të dënojmë çdo akt të dhunës që bëhet kundër KFOR-it.

Ne kërkojmë nga Qeveria të pranojë këshillat dhe alternativat që dalin nga përfaqësuesit e popullit, pra nga Kuvendi i Kosovës. por assesi dhe në asnjë mënyrë ata që ato mendime, alternativa që shkojnë apo na qojnë në konfrontim me aleatët tanë ndërkombëtarë.

Problemi i veriut nuk zgjidhet duke shkatërruar perspektivën e pjesës tjetër të Kosovës. problemi i veriut zgjidhet duke integruar atë pjesë me pjesën tjetër të Kosovës. Kjo bëhet vetëm me veprimet e mençura dhe strategjike që po bën Qeveria në bashkëpunim dhe bashkëveprim me aleatët tanë ndërkombëtarë. Frytet e këtij bashkëpunimi dhe bashkëveprimi mund të preken dhe po i ndien çdo qytetar i këtij vendi.

Unë po ua përkujtoj se suksesi më i madh pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 25 korrikut, është unifikimi në mendim dhe në veprim dhe mbështetja e fuqishme e botës demokratike për veriun e Mitrovicës. Po ua përkujtoj deklaratën e kancelares Merkel dhe, së fundi, deklaratën dhe mbështetjen e fuqishme të presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotit Barack Obama, i cili flet për veriun e Mitrovicës.

Raportet e krijuara me aleatët tanë ndërkombëtarë të botës demokratike s'janë rezultat i një dite, një nate, por janë si rezultat i përpjekjeve në dy apo tri dekadat e fundit. Prandaj, ne i sigurojmë partnerët ndërkombëtarë se rrugën e filluar para shumë kohe, do ta qojmë deri në fund. Kjo do të përfundojë me sovranitet të plotë në tërë territorin e Kosovës për gjithë qytetarët, me shtrirjen dhe ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit tonë, pra, për ma saktë, në 10.908 kilometra katërorë. Këto janë qëndrimet e miqve tanë ndërkombëtarë, këto janë qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe gjithsesi i mbështet Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, për jetë më të mirë, më të sigurt për gjithë qytetarët e vendit.

Grupi Parlamentar i PDK-së angazhohet për integrim në BE, në NATO e assesi nuk lejon që të ndodhin veprime që çojnë Kosovën drejtë izolimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Ismet Beqiri, kryetar i grupit.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës i ka ndjekur dhe i ndjek me shqetësim zhvillimet në veri të vendit, pjesë në të cilën për shumë vite është rrezikuar rëndë siguria e vendit, ka lulëzuar dhe vazhdon të lulëzojë krimi i organizuar.

Lidhja Demokratike e Kosovës i ka vlerësuar dhe i vlerëson kriminale veprimet e bandave serbe, veprime të cilat kanë qenë dhe janë drejtpërdrejt të nxitura, të përkrahura dhe të financuara nga institucionet e shtetit fqinj serbë dhe strukturat ilegale dhe kriminale serbe në veri të vendit.

Si subjekt politik, edhe si qytetarë i kemi gjykuar rëndë, veçmas vrasjen e policit të Kosovës, Heroit të Kosovës, Enver Zymeri, lëndimin e policëve tjerë, lëndimet e ushtarëve të KFOR-it, djegien e pikave kufitare, djegien e pronës së shtetit të Kosovës, e mbi të gjitha rrezikimin e jetës së qytetarëve dhe të atyre që janë në shërbim të rendit dhe ligjit.

LDK-ja ka përkrahur dhe përkrah veprimet e institucioneve përgjegjëse në drejtim të shtrirjes së sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës në zbatimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë në tërë territorin e vendit tonë.

LDK-ja vazhdimisht ka thënë, edhe sot e përsërisim, se ajo që është në interes të shtetit, do ta përkrahim. Prandaj, kemi përkrahur dhe përkrahim veprimet për shtrirjen, gjegjësisht sundimin e ligjit dhe të rendit edhe në veri të Kosovës. Ajo që për LDK-në ka qenë dhe mbetet shqetësim, që për ne nuk do të duhej të përsëritej, është mos koordinimi i duhur me rastin e aksionit 25 korrikut. Ky koordinim ka munguar me ata që është dashur të bëhej, gjithsesi, pra KFOR-in, si një mekanizëm i respektuar, autoritativ, kredibil në Kosovë, i mandatuar dhe kompetent për sigurinë në vend, si dhe EULEX-in.

Pavarësisht nga kjo, ne e mbështesim së paku tentimin fillestar për vënien e rendit dhe rregullit me aksionet e përgatitura dhe ligjore. Nga këto veprime duhet të përfitojë Kosova, duhet të përfitojnë të gjithë. Pa dyshim, do të ketë kohë që të flitet edhe për lëshimet, sepse jemi të bindur se 16 shtatori dhe zhvillimet e mëvonshme, pse jo edhe të këtyre ditëve, na jep të drejtë për këtë që themi për 25 korrikun.

Ajo që ka bërë dhe po bën KFOR-i, në asnjë mënyrë nuk i jep të drejtë Qeverisë të bëjë sehir, të jetë vetëm vrojtues, por ajo duhet të bëjë punën e saj, sepse jo të gjitha punët mund dhe duhet t'i bëjë KFOR-i. Ka edhe punë të tjera për të bërë, për të bërë strategji të caktuar, detajuar, për veprime tjera në drejtim të shtrirjes së autoritetit tonë shtetëror, sepse veprimet ad-hoc nuk mund të japin rezultate, përkundrazi. Për ne është e qartë dhe për këtë jemi të gjithë dëshmitarë që atje për të bërë këtë, na duhet edhe punë më e madhe, edhe veprime më të vendosura dhe përkrahje vendimtare politike të faktorëve

vendimmarrës ndërkombëtarë, siç janë Brukseli dhe Uashingtoni, përkrahje që mendojmë se e kemi, por që duhet të dimë ta ruajmë dhe kultivojmë këtë mbështetje me veprime të mençura, vendosmëri, strategji dhe vizion të qartë, e në asnjë mënyrë me veprime sot për nesër.

LDK-ja rithekson edhe një herë se për ne, si dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, mbi të gjitha është me rëndësi ruajtja e sovranitetit territorial të Kosovës në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe pakos së Ahtisarit, që ofrojnë hapësirë për jetë të lirë për gjithë qytetarët.

LDK-ja edhe me këtë rast e përsërit se bisedimet po tregohen të paefektshme, të papërgatitura mirë. Ato po zhvillohen në interes të Serbisë, e cila kinse po ofron marrëveshje, por ato nuk po i implementon. Nuk kemi qenë dhe as nuk jemi kundër dialogut, por jemi kundër një dialogu sa për të thënë se po dialogojmë, e atëherë më tepër konsiderojmë se këto biseda më shumë janë në favor të Serbisë, e fare pak ose aspak në të mirë të Kosovës.

LDK-ja konsideron se edhe heqja e masës së reciprocitetit, pas vendosjes së drejtë të saj, është vendim i gabuar i Qeverisë së Kosovës. LDK-ja konsideron se të gjitha ato që po ndodhin në veri, janë veprime vetëm fillestare. Ato duhet të shtrihen gradualisht edhe në segmente tjera të jetës institucionale në veriun e Kosovës, siç janë kthimi sa më parë i gjykatësve shqiptarë dhe të tjerë, funksionalizimi i gjykatës në Mitrovicë, formimi i komunës së Mitrovicës, shpërbërja e strukturave kriminale e të tjera.

LDK-ja konsideron se heqja e barrikadave dhe qarkullimi i lirë i qytetarëve dhe mallrave është një e drejtë elementare njerëzore, por barrikadat më të mëdha për sundimin e rendit dhe të ligjit në veri të Kosovës janë strukturat ilegale dhe bandat kriminale të organizuara dhe të përkrahura në çdo aspekt nga Qeveria serbe. Ato duhet eliminuar, sepse janë e keqja më e madhe që po u ndodhë qytetarëve shqiptarë, por edhe të tjerëve.

LDK-ja mbështet fuqishëm veprimet e KFOR-it dhe e inkurajon që të vazhdojnë me vendosmëri në zbatimin e mandatit të tyre. Veprimet e vendosura të KFOR-it, mosnënshtrimi ndaj presioneve dhe shantazheve e lojërave të ndyta politike që dinë të bëjnë qeveritarët serbë, kjo ndër të tjera do të thotë se KFOR-i dhe EULEX-si mbrojnë jo vetëm ligjshmërinë, kushtetutshmërinë, sovranitetin e Kosovës, por në një mënyrë mbrojnë edhe dinjitetin dhe autoritetin e NATO-s, BE-së, pra të Brukselit dhe të Uashingtonit, fundi i fundit ata mbrojnë ligjshmërinë, demokracinë, fatkeqësisht këto terma të panjohura për zyrtarët serbë dhe ilegalët e veriut.

Zonja dhe zotërinj,

LDK-ja rithekson edhe një herë mbështetjen e saj për vendosjen e rendit dhe ligjit në veriun e vendit, për zbatimin e pakos së Ahtisarit, për ndjekjen dhe arrestimin e kriminelëve të veriut dhe jo vetëm të veriut.

LDK-ja insiston në faktin se koordinimi i veprimeve në mes të institucioneve përgjegjëse të sigurisë, KFOR-it, EULEX-it dhe institucioneve vendore, është i vetmi garantë për sukses në fillimin e vendosjes së rendit dhe ligjit, luftimit të krimit të organizuar,

korupsionit në atë pjesë të territorit të shtetit tonë. As që kemi qenë dhe as që do të jemi për veprime të pamatura, të papërgatitura, të pavendosura, të cilat do të rrezikonin në çfarëdo mënyre jetën e qytetarëve.

LDK-ja konsideron se janë momente të rëndësishme të veçantë të fillimit të funksionalizimit të tërë shtetit tonë, nuk është koha e marketingjeve politiko-qeveritare apo partiake. Le ta kryejnë punën e vet të gjithë ata që janë kompetent vendorë e ndërkombëtarë, pastaj do të kemi kohë të shohim se kush çfarë bëri e çfarë nuk bëri.

Nuk është koha për kurrfarë krekosje as të Qeverisë, ka edhe shumë punë për t'u bërë dhe ende jemi larg për t'u sjell në mënyrë triumfaliste. Sigurisht që edhe ne pajtohemi që nuk do të duhej të merremi me atë se kush çka ka bërë që 12 vjet, sepse vetëm po ua rikujtoj, për 12 vjet, Qeveria e përkohshme dhe tri mandate të pasluftës, i ka udhëhequr Partia Demokratike e Kosovës. Edhe një herë e përsërisim, për ne është me rëndësi sundimi i rendit dhe i ligjit dhe ndarja e mirënjohjeve dhe e dekoratave edhe e përgjegjësisë do të vijë kur atje të sundojë ligji dhe rendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Grupit “Vetëvendosje”, deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kur po e dëgjoja kryeministrin Thaçi, teksa nuk thoshte asgjë, m'u forcua bindja që kryeministri e merr fjalën në seanca plenare, në mënyrë që qytetarët ta ndërrojnë kanalin televiziv, kurse deputetët të nisin të shkruajnë mesazhe telefonike, ta shfletojnë ndonjë gazetë ose edhe të dalin jashtë për cigare.

Kryeministri Thaçi do që qytetarët të bëhen të paimterësuar për politikën, ashtu qysh ky është i paimterësuar për qytetarët. Këtu u bë thirrje për forcimin e unitetit midis subjekteve politike. Forcimi i unitetit, unitet për çka? Për zmbrapsjen nga veriu, për lejimin e mallrave të Serbisë në Kosovë, për bisedime me Serbinë, unitet për ta shitur pasurinë e Kosovës, natyrisht që jo! Ne jemi për unitet për të mirën e Kosovës dhe jo për unitet me të këqijat e Qeverisë.

Sa herë që Qeveria dështon, gabon ose mashtrohet, ajo kërkon shpëtim te bashkësia ndërkombëtare. Faktorët ndërkombëtarë, presidenti Obama, e përkrahin atë që ekziston. Kur e kishim në veri Policinë e Kosovës, e përkrahin Policinë e Kosovës dhe sovranitetin për Kosovë, kur atje është vetëm KFOR-i, e përkrahin KFOR-in dhe qetësinë e paqen.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në interpelancën e 5 majit u pat votuar mocioni në pikën e tretë të të cilit thuhet që Qeveria e Kosovës duhet të informojë rregullisht çdo tre muaj Kuvendin e Kosovës për përpjekjet e saj për të vendosur kontroll në tërë territorin e Kosovës. Asnjëherë nuk pati kurrfarë informimi a llogaridhënie zyrtare, institucionale e specifike të Qeverisë për këtë gjë.

Pas raundit të pestë të bisedimeve në Bruksel, në fillim të korrikut, zyrtarë të kësaj Qeverie patën deklaruar që nga 1 nëntori i këtij viti s' do të ketë më struktura paralele të Serbisë në Kosovë. Kanë mbetur vetëm edhe 4 ditë që të përmbushet ky premtim, ndërkohë që asnjë strukturë e vetme ilegale e Serbisë nuk është shpërbërë, përkundrazi. Është premtuar që pas 1 nëntorit nuk do të ketë më zyra që lëshojnë tabela të vjetra ilegale të Serbisë në Kosovë dhe ky afat u shty edhe për dy muaj të tjerë tash për tash, ndërkohë që kjo Qeveri para Serbisë dhe Bashkimit Evropian është zotuar që do të prodhojë tabela të UNMIK-ut edhe për 5 vjet të tjera, në kundërshtim me zotimet para qytetarëve, ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës. E gjithë kjo është pasojë e bisedimeve pa kushte për Serbinë, të cilat nuk i shtojnë sovranitet Kosovës, por i shtojnë tema dialogut në Bruksel.

Bisedimet e drejta do të ishin vetëm ato që i vënë kushte Serbisë. Këto kushte do të mund t'i përmbledhim në dhjetë pika kryesore:

E para, Serbia duhet ta pranojë pavarësinë e Kosovës.

E dyta, duhet ta ndryshojë Kushtetutën e saj, ku shkruan që Kosova është pjesë e Serbisë.

E treta, duhet t'i kërkojë falje Kosovës për krimet ndaj shqiptarëve përgjatë gjithë shekullit XIX –XX.

E katërta, duhet të na i dorëzojë kriminelët serbë të luftës.

E pesta, duhet të na i kthejë trupat e rreth 1800 të pagjeturve.

E gjashta, duhet të na i paguaj dëmet e luftës dhe okupimit.

E shtata, duhet ta ndërpresë dhunën sistematike, diskriminimin, shtypjen dhe terrorin ndaj shqiptarëve autokton në Luginën e Preshevës.

E teta, duhet të pushojë financimin e strukturave të saj në Kosovës.

Dhe, e nënta, duhet t'i kthejë depozitat bankare të qytetarëve të Kosovës, Fondin pensional, librat kadastral dhe ata të amzës, artefaktet kulturore, që të gjitha këto të plaçkitura.

Dhe, së fundi, e dhjeta, Serbia duhet t'i kapë ata dhjetëra kriminelë serbë të luftërave të viteve '90 që shëtitin të lirë e të pacenuar nga prokuroria e shtetit. Po e vë theksin te kjo e dhjeta, për shkak se vetëm asisoj do ta kishim një Serbi tjetër, një Serbi të ndryshme, një palë të kualifikuar për dialog parimor.

Bisedimet me Serbinë, pa kushte për Serbinë, janë sinjal për Serbinë që ajo s' ka nevojë të ndryshojë. Bisedimet pa kushte janë bisedime joparimore dhe pashmangshëm bëhen bisedime për çështje të brendshme të Kosovës. Bisedimet me një Serbi hegjemonike dhe shoviniste, pa kushte për këtë Serbi, janë njohja e aspiratave dhe e apetiteve të saj. Pa e kushtëzuar Serbinë, përfundon i kushtëzuar prej Serbisë.

Përderisa qeveritarët kosovarë premtojnë se Serbia do të pranojë Kosovën në fund të bisedimeve, sot është Kosova ajo që tashmë e pranoi Serbinë me fillimin e këtyre bisedimeve. Qeveritarët kosovarë thonë se me dialogun në Bruksel do ta bëjnë normalizim e marrëdhënie të Kosovës me Serbinë, mirëpo, ky normalizim po e ndryshon Kosovën dhe jo Serbinë. Natyrisht që normalizimi i marrëdhënieve duhet ta ndryshojë njërin prej palëve, por normalizimi i vërtetë i marrëdhënieve është ai normalizim i cili e ndryshon Serbinë e jo Kosovën, siç po bëhet me këtë dialogun në

Bruksel. Në Bruksel janë arritur konkluzionet e dakorduara me Serbinë e pakushtëzuar për çështje të brendshme të Kosovës. Serbia e pakushtëzuar është gjithsesi Serbi e pandryshuar. Por, asgjë s'ka filluar sot. Kjo qeveri aktivisht e ka toleruar Serbinë brenda Kosovës. Tolerimi jo vetëm që nuk shpaguhet, por ai paguhet shtrenjtë, sepse i trimëron strukturat ilegale, armiqësore dhe kriminale të Serbisë në veri dhe jo vetëm atje. Komuna e veriut të Mitrovicës, sipas planit të Ahtisarit është shpërblim për pastrimin etnik të shqiptarëve në kohën e pasluftës atje. Ruajtja e pagave të policëve serbë që punonin për Serbinë në Kosovë, e në fund vetëm suspendoheshin me pagesë, sigurisht që po ashtu paraqet inkurajim për Serbinë dhe strukturat e saj.

Përfundimisht, kjo Qeveri po e shet politikisht dhe ekonomikisht shtetin e Kosovës për pushtet të vetin. I gjithë shqetësimi i saj është si t'ia shesë popullit të Kosovës këtë shitje të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kush do të flasë?

Deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Ne do të flasim për veriun e Kosovës, siç po duket, edhe një kohë dhe do të flasim sepse kjo Qeveri e Kosovës, shihet qartë se nuk është e përgatitur për ta zgjidhur, për të qetësuar dhe normalizuar situatën në veri të Kosovës.

Ne do të flasim për veriun e Kosovës edhe më tutje, siç po duket, sepse kjo Qeveri e Kosovës nuk e ka as përkushtimin për ta normalizuar situatën atje.

Mbi të gjitha, sikurse u pa në këtë interpelancë, Qeveria e Hashim Thaçit nuk ka as plan, nuk ka një dokument strategjik mbi të cilin do të duhej t'i detajojë veprimet e veta një nga një. Dhe në mungesë të planit, apo të këtij dokumenti strategjik, Qeveria e Kosovës normalisht se nuk po mund të ndërmarrë hapa të rinj. Tashmë po i duket e mjaftueshme Qeverisë së Kosovës që ta bëjë vetëm një gjë, të falënderojë KFOR-in. Madje, në mënyrë të çuditshme dalin formulime si - Qeveria e përkrah KFOR-in. Po, normalisht që e përkrah KFOR-in, pse a keni menduar ndonjëherë për të bërë ndryshe diçka? A keni menduar ndonjëherë të dilni për të thënë që KFOR-i nuk duhet të vendoset atje. Normalisht se duhet përkrahur, por jo vetëm të thuhet - po e përkrahim, por duhet të jemi pjesë e planeve të përbashkëta.

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës po e ndjek me shqetësim përkeqësimin e gjendjes dhe përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes në veri të Kosovës, pas tre muajve prej se është tentuar që të merret ajo pjesë nën kontroll të shtetit. Më 26 korrik, një ditë pasi

filloi operacioni atje, AAK e mbështeti Qeverinë e Kosovës dhe i kërkoi asaj që të çojë deri në fund vendosjen e sundimit të ligjit në veri të Kosovës.

Më 10 gusht të këtij viti, ne i thamë Qeverisë se veprimet gjysmake e dëmtojnë rënd funksionalitetin e shtetit të Kosovës dhe e vë në dyshim arritjen e rezultateve të pritura. Edhe tash, më shumë se 3 muaj prej 25 korrikut, situata në veri të Kosovës nuk është normalizuar dhe madje është shumë larg të qenit e normalizuar. Ne insistojmë që të ndërmerren masat që në atë pjesë të Kosovës të përmirësohet jeta e qytetarëve të Kosovës dhe të normalizohet gjendja në kuptimin e sundimit të ligjit, dhe mos harroni se shtrirja e autoritetit të shtetit të Kosovës, nuk ka të bëjë vetëm me tentimin për vënien nën kontroll të pikave kufitare doganore, por shumë më shumë.

Ne po i përsërisim kërkesat tona për Qeverinë e Kosovës, sa i përket veriut të Kosovës.

1. Të fillojë që përmes një grupi ndërministror të përmirësojë jetën në veri dhe të normalizojë situatën atje, është më mirë vonë se sa asnjëherë, më mirë vonë se kurrë.
2. Të krijojë një fond të veçantë më të madh për atë pjesë të Kosovës, për normalizimin e situatës dhe jetës atje, dhe
3. Të shtojë prezencën e shërbimeve emergjente dhe të shërbimeve të sigurisë publike në atë pjesë të Kosovës.

Ne i kërkojmë Qeverisë të Kosovës që të fokusohet, në të paktën në këto 20 aspekte dhe këto janë përsëritje, sepse i kemi kërkuar dhe më 10 gusht: investimet kapitale që ndikojnë në përmirësimin e jetës, ndërhyrjen emergjente në rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve të asaj pjese, sigurinë e përgjithshme në atë pjesë të territorit, shuarjen e strukturave ilegale, arrestimin e udhëheqësve të kontrabandës dhe rrjeteve kriminale, rritjen e sigurisë publike, rritjen e sigurisë në trafik, prezencën e shtuar të Policisë së Kosovës dhe sidomos asaj të trafikut, ndërtimin e nënstacioneve policore në disa lokalitete, kërkesë kjo që është më shumë se tri vjet, prezencën e shtuar të shërbimeve emergjente, e dini se atje nuk ka zjarrfikës dhe çfarëdo gjendje që ndodhë atje, nuk ka mundësi ndërhyrje, vendosjen e gjyqësorit, respektivisht rifillimin e funksionimit të gjykatave, zhvillimin dhe fuqizimin e këshillave komunalë të sigurisë në bashkësi, ngritjen e nivelit të trajtimit të informatave inteligjente që vijnë nga Agjencia Kosovare për Inteligjencë, trajtimin e rasteve të prishjes ose rrezikimit të sigurisë publike, jo si raste të izoluara, sikurse po ndodh tash, zhvillimin e koordinimit brenda vetë Policisë së Kosovës, e cila tashmë duket që po kalon një fazë konfuze, ngritjen e nivelit teknik ose të kontrollimit teknik të automjeteve, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, vendosjen e sinjalizimit të plotë rrugor, ndërtimin emergjent të ambulancave, furnizimin me barëra dhe pajisje për ndërhyrjen mjekësore.

Këto fusha duhet të përcillen me plane të posaçme të veprimit për secilën pikë, në mënyrë që jeta e qytetarit në atë pjesë të mund të arrijë të ndryshojë. Zbatimi i këtyre veprimeve të Qeverisë për normalizimin e situatës në veri duhet të jetë në koordinim të

ngushtë me NATO-n, e para së gjithash me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe vendet e fuqishme të Bashkimit Evropian, sikurse Gjermania dhe të tjera.

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Edhe kjo interpelancë, edhe këto deklarime të deritashme tregojnë fuqishëm se sa konfuze është Qeveria e Kosovës dhe sa larg të vërtetës janë qytetarët e Kosovës. Edhe sot këtu po dëgjojmë të njëjtat fjalë, sikurse gjatë këtyre 3 muajve, madje kryeministri Hashim Thaçi, gjatë këtyre javëve na tha se as NATO që 12 vjet s' ka pasur qasje në pikat kufitare doganore 1 dhe 31. Nuk e thotë të vërtetën.

Në pikat 1 dhe 31, të nderuar, jo vetëm që ka pasur KFOR, por ka pasur edhe SHPK, ka pasur edhe dogana ose doganierë të Kosovës. Në veri ka pasur edhe gjykata, ka pasur edhe zyra të regjistrimit civil, ka pasur edhe Fond pensional, edhe...

(Ndërhyrje)

(...Shaip, prit, kur ta kryej, fol, s' është problem). Por, më 19 shkurt 2008, dy ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, grupet kriminale i kanë djegur pikat kufitare dhe doganore 1 dhe 31, më pas Hashim Thaçi vendosi Doganën e Kosovës në jug të Mitrovicës, aty de fakto e vendosi një kufi të ri doganor.

Qytetarët e Kosovës, kryeministër, por edhe Shaip Muja e di të vërtetën. Qytetarët e Kosovës e dinë se ju e keni cilësuar si folklorizëm patriotik për tri vjet me radhë, sa herë që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka kërkuar prej juve vendosjen e kontrollit kufitar dhe doganor.

E dinë se ju dhe Qeveria e juaj e keni cilësuar Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës si të frustruar dhe të dhunshme sa herë që kemi kërkuar gjatë këtyre tri vjetëve ta ndalim dhe ta luftojmë krimin e organizuar dhe korrupsionin në veri të Kosovës dhe kontrabandën, normalisht.

Ju personalisht, zoti Thaçi, në këtë Kuvend, vitin e kaluar keni thënë se nuk ka struktura paralele në Kosovë, janë disa individë të frustruar, por nuk ka struktura të organizuara paralele, tash e thoni të kundërtën. Ju edhe Qeveria e Kosovës keni dështuar edhe në zbatimin e asaj të famshmes Strategji për veriun e Kosovës. Ju nuk keni përmendur në asnjë fjalë të vetme Strategjinë nacionale e sigurisë së Kosovës, se Kosova ka problem me struktura ilegale edhe me Serbinë. Po ua përsëris, qytetarët e dinë të vërtetën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Replikë, zoti Muja.

SHAIP MUJA: Zoti kryesues,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Unë ndërhyra për shkak të dezinformimeve publike që zoti Ramadani i jep publikut se kanë funksionar SHPK-ja dhe unë i thashë që kanë funksionuar si manekenë atje dhe kanë qenë në bashkëpunim me strukturat të cilat nuk kanë funksionuar në mbajtjen e rendit, por në vështtrimin e funksionimit të kontrabandimit dhe mosfunksionimin e ligjit. Prandaj, nuk është mirë të krijohet, qasjet që janë duke u bërë sot, janë që ato qasje të jenë në drejtim të forcimit të rendit dhe të ligjit, e jo vetëm të formës. Dhe, para kësaj Qeverie dhe para këtyre dy qeverive që shkuan, kanë qenë vetë në pushtet dhe nuk kanë të dhëna të cilat janë inkurajuese se atje do të funksiononte shteti dhe ligji. Prandaj, për ata nuk është mirë të dezinformohet opinioni dhe publiku dhe të thuhet se ka pasur atëherë, por tash nuk funksionuan, sepse u bënë këto ose disa arsye të cilat nuk kanë asnjë bazë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Kundër replikë, zoti Ramadani!

BURIM RAMADANI: Është e çuditshme qysh deputeti Muja tash policët e Kosovës i quan manekenë, ndërsa pikërisht ata të cilët e kanë udhëhequr në kohën para shpalljes së pavarësisë, në atë pjesë të Kosovës, tash po promovohen brenda Policisë së Kosovës. Zoti Muja dhe të tjerët e dinë se e vërteta është se atje ka pasur polici të Kosovës, në atë kohë është quajtur Shërbimi Policor i Kosovës, ndoshta zoti Muja nuk e di, por ata nuk kanë qenë manekenë, është fyerje për ta. Ata kanë punuar me krejt përkushtimin e vet, kanë rrezikuar jetën e vet, ndërsa ju i quani manekenë. Kjo është totalisht e papranueshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Një minutë, zoti Muja!

SHAIPI MUJA: Unë SHPK-në nuk jam duke e quajtur manekenë, por vetë Ministria ku ka punuar zoti Ramadani, i ka shndërruar një pjesë të tyre në manekinë, sa për formë. Prandaj, le të na tregojë cilat janë rezultatet dhe mos të shpallë të pavërteta dhe shpifje. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar, Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Përshëndetje, për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar dhe për të gjithë deputetët e kuaj seance!
Bllokadës në veri duhet t'i jepet fund dhe premtimet e Qeverisë duhet të përmbushen, e cila në vazhdimësi është treguar e kujdesshme sa i përket sjelljes ndaj situatës në veri, po ashtu edhe në raport me partnerët ndërkombëtarë.

Duhet të intensifikohen përpjekjet për heqjen e bllokadave, dhënies fund dhunës së ushtruar nga serbët, përfshirë atë ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, e dënuar kjo ashpër edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet ambasadorit të saj, zotit Kristofor

Dell, po ashtu edhe qëndrime të shprehura qartësisht nga Gjermania, si dhe të gjitha vendet tjera mike.

Roli i misioneve ndërkombëtare në zhbllokimin e veriut është i pakontestueshëm, prandaj Qeveria nuk mund të akuzohet për atë që ajo sillet konform situatës dhe rrethanave, ndërkohë që kërkojmë nga vendet e BE-së të shtojnë presionin ndaj Serbisë dhe të kushtëzojnë integrimin e saj me zgjedhjen problemeve në Kosovë.

Qeveria e Kosovës, ashtu siç ka vendosur më parë, duhet t'i shtojë përpjekjet për investime për të mbrojtur sa më shumë qytetarët shqiptarë atje, të rrezikuar nga bandat dhe kriminelët serbë. Po ashtu, duhet të krijojë kushte së bashku me bashkësinë ndërkombëtare, që të ndryshojë jetën e komunitetit serb, i cili gjithnjë e më shumë po tregon lodhje nga jeta nën barrikada dhe bllokimi i tyre.

Qeveria duhet të jetë e kujdesshme që të mos mbetet në pozita inferiore apo e përjashtuar nga procesi në veri, prandaj inkurajojmë KFOR-in, EULEX-in që të jenë sa më bashkëpunues me Qeverinë, Presidencën dhe përgjithësisht institucionet e Kosovës sa u përket të gjitha zhvillimeve në veri, situatë ko që është e ndërlidhur edhe me ardhmërinë e vendit. Po ashtu, edhe ne si grup mbështesim përmbushjen e plotë të Rezolutës për verin, të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e datës 28 korrik të këtij viti.

Sa i përket përsosjes së bisedimeve politike me Serbinë, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, është kundër hapjes së çfarëdo teme të tillë që paralajmëron apo mundëson tejkalimin e zgjedhjes që ofron pakoja e presidentit Ahtisari, e cila besojmë fuqishëm, mbetet pika referente për çdo forcë politike dhe si e tillë e patejkalueshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Selmani!
Fjalën e ka përfaqësuesi i SLS-së, zoti Miletiq.

PETAR MILETIĆ: Poštovani podpredsedniće Skupštine,
Članovi Vlade,

Poštovane kolegice i kolege poslanici,

Problem na severu Kosova je dugo guran pod tepih, naj taj način zapušten i danas imamo vrlo komplikovanu situaciju, koja ne može da se reši jednim potezom i takođe ne verujem ni da se može rešiti u koliko u tom procesu ne učestvuju četiri ključna faktora, a to su međunarodna zajednica, Priština, Beograd i lokalno stanovništvo sa severa Kosova.

Svi ovi faktori imaju svoje interese za koje tvrde da su legitimni. Pre nego što dođe do bilo kakvog političkog razgovora o severu Kosova, neophodno je da se stanje na terenu koliko toliko normalizuje. To podrazumeva uklanjanje barikada, a jedini ispravan način je da to bude dobrovoljno uklanjanje bez upotrebe sile. Verujem da je to moguće i takođe da je to preduslov kako bi došlo do procesa rešavanja celokupne političke situacije na severu.

Kada kažem da je situacija komplikovana, onda to ne govorim kao političku frazu, bez idejnih političara sa obe strane, već mislim na grešku u jednodimenzionalnim pogledima na ovaj problem, jer stvarnost nije crno-bela. Tako je neprihvatljivo da se stvara u javnosti atmosfera da su svi Srbi na severu kriminalci, jer to nije tačno i ogromna većina tog naroda želi normalan život za svoje porodice.

Pokušajima da se kriminalizuje stanovništvo, ne stvara se pogodna atmosfera za normalizaciju stanja i sa ove govornice apelujem na sve političke činioce da treba stvarati atmosferu poverenja a ne mržnje. Najgore od svega što bi Skupština Kosova danas mogla da uradi, je da prihvati preporuke Pokreta „Samoopredeljenje“ i da, kako oni traže, pošalju policijske snage na severu Kosova. To ne bi rešilo problem, već bi ga dodatno zakomplikovalo, i čudi me odsustvo svake odgovornosti, jer ovakva inicijativa može dovesti do eskalacije sukoba i novih žrtava, čemu se Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke najoštrije suprotstavlja.

Prihvatanje ovakvog zahteva bi poništilo sve dosadašnje napore odgovornih političara koji su imali za cilj mirnu i stabilnu situaciju na Kosovu i stvaranje ambijenta za rešavanje nagomilanih socijalno-ekonomskih problema. Siguran sam da se svi sećamo negativnih iskustava iz bliske prošlosti, kako pozivanje na nasilje može izmaći kontroli, a tada građani gube živote a problem ne bude rešen, već se dodatno komplikuje.

Odgovornost za situaciju na severu preuzeo je KFOR i smatram da general Devs dobro menadira krizom i da mu u tom smislu i Skupština Kosova treba pružiti podršku.

Prekid dijaloga Prištine i Beograda, a što je prvi zahtev ovih preporuka, bila bi greška nesagledivih razmera. Jedna takva odluka bila bi politički nezrela i obzirom da se političko delovanje stranke kojoj pripadam, zasniva na dijalogu a ne sili, mi ćemo biti protiv ovog predloga.

Na ceo ovaj dokument, predložen od strane pokreta „Samoopredeljenje“, gledam kao na jeftino prikupljanje političkih poena a ne na želju da se reši problem, koji već sada ima međunarodne razmere. Već duže vreme u ovom parlamentu, pokret „Samoopredeljenje“ širi anti srpsku atmosferu, protivi se svemu onome što za cilj ima suživot na Kosovu i u tom svetlu gledam i na ovu inicijativu. Nije prvi put da pokret „Samoopredeljenje“ poziva na nasilje. Kada se jedan od poslanika ovog pokreta pravdao da je vlasnik kamiona koji su prevrnuli kod Podujeva, bio Srbin a ne Albanac iz Preševa, šalje poruku da je dozvoljeno napadati Srbe i da to može činiti nekažnjeno.

Institucije Kosova moraju svim građanima Kosova jasno staviti do znanja da će nasilje biti kažnjeno po zakonu. U protivnom, stvara se osećaj kod ljudi da mogu uzimati pravdu u svoje ruke, što ojačava ekstremiste a slabi institucije.

Mi i dalje nećemo odgovarati na provokativne stavove ovog pokreta, jer želimo da ova institucija zadrži neophodan ugled i da građanima šaljemo poruke mira i suživota.

Zahteve koji za cilj imaju nove sukobe, hapšenja i destruktivne akcije, mi nećemo podržati. Umesto toga, mislim da institucije Kosova imaju puno posla i južno od Ibra i treba da preventivno deluju kako se ne bi dešavali slučajevi, kao što su ubistva u Zrzu kod Orahovca i Dobruši kod Peći.

Interesantna je podudarnost zahteva pokreta „Samoopredeljenje“ i odbornika 4 opštine sa severa Kosova da se prekine dijalog Prištine i Beograda i da i jedni i drugi pozivaju vojske i policije na sever. To mi govori da ove dve grupe ljudi dele isti sistem vrednosti, jedina je razlika etnička pripadnost. I pored teške i složene situacije na severu, i dalje verujemo da je dijalog jedini način za održivo rešenje problema.

Za fizičko uklanjanje barikada nije neophodna kosovska policija, i svakome je jasno da bi to u svakom trenutku mogao da uradi i KFOR, ali iskusne međunarodne diplomate znaju da to nije održivo rešenje i da nasilno uklanjanje barikada ne bi dugoročno rešilo problem. Zbog svega ovoga, Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke biće protiv ovog zahteva i poziva sve razumne ljude u ovom Parlamentu da učine isto i da umesto toga, pošaljemo poruku da smo iskreno opredeljeni za mirno rešenje izlaska iz krize putem dijaloga. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Hvala! Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar, deputeti Danka!

FİKRİM DAMKA: Sayın Meclis Başkanı yardımcısı, Sayın Başbakan yardımcısı, Sayın Bakanlar ve değerli milletvekilleri

Kosovanın uzun zamandır sorunlu olan Mitroviça bölgesinde kalıcı bir barışın ve çözümün sağlanmasının Türk, Boşnak ve Rom toplumu açısından son derece önemli olduğunu ilk önce vurgulamak istiyorum.

Kosova vatandaşı olarak Kosovanın kalkınması ve Avrupa Birliği ile entegrasyonu konusunda atılacak adımların, önünü kesen bu çözümsüzlük ve huzursuzluk herkesi rahatsız ettiği gibi bizi de rahatsız etmektedir.

Hükümetin başlatmış olduğu bu girişimi daha önce de söylediğimiz gibi barış açısından ve bu bölgenin orda yaşayan vatandaşların Kosova kurumlarına entegrasyonun sağlanması gerekliliğini desteklediğimizi vurgulamak istiyorum.

Kuzey Mitroviçada bugün güvenlik probleminin olduğu ortadadır. Burda yaşayanın Türk, Boşnak ve Rom toplumunu da olduğunu altını çizmek istiyorum ve burdaki ailelerin güvenlik sorunuyla karşılaştığını ve tedirgin olduklarını bildirmek istiyorum. Lütfen KFOR ve Kosova güçlerinin bu konuda hassas olmalarını ve dikkatli davranmalarını talep ediyorum.

Kuzey Mitroviçada çözümün kalıcı olması için yalnız Kosova kurumlarının ve siyasetçilerin çabası ve iyi niyetli yetmeyeceği ortadadır bu çözüme her tarafın katkıda bulunması gerektiği ve uluslararası toplumun daha duyarlı davranmasını 6+Parlamento grubu adına talep ediyorum.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pas diskutimeve të para, i kanë mbetur PDK-së 28 minuta, LDK-së 33 minuta, “Vetëvendosjes” 11, AAK-së 10, Kosovës së Re 10, SLS-së 11, “6+” 2 minuta.

Tani po vazhdojmë me pjesën e dytë, që do të thotë me diskutimet e deputetëve.

(Reagime nga salla)

Jo, jo, është e rregulluar me Rregullore kjo punë, ne e kemi të rregulluar atë punë saktë, regjia nuk gabon. 15 minuta i ka kryeministri, kohën tjetër, minutazhin tjetër e merr nga grupi parlamentar.

Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Problemi i veriut të Kosovës është problem i cili gjenezën e ka nga regjimi i kaluar serb, i cili në vitin 1987 themeloi komunat veriore të Zveçanit dhe Zubin-Potokut, si parapërgatitje për ndarje të Kosovës në momentet e caktuara, nga regjimi i kaluar serb, që në këtë vend solli shumë vuajtje dhe pikëllim. Edhe Qeveria e tanishme e Serbisë e ka pasur të vështirë të heqë dorë nga ajo politikë e ndarjes së veriut, andaj edhe ... në këtë ëndërr, duke financiar strukturat kriminale në veri dhe kjo për Serbinë mbetet vetëm ëndërr e parealizuar si shumë të tjera.

Ky problem nuk u zgjidh as me përfundimin e luftës. Autoritetet e Kombeve të Bashkuara, UNMIK-u, si autoriteti më i suprem, nuk arriti që atë pjesë të Kosovës të vë në kuadër të rendit dhe ligjit. Ata lejuan funksionimin e strukturave paralele, sot të identifikuar si struktura kriminale që mbajnë peng përkohësisht lirinë e lëvizjes.

Prej vitit 1999, UNMIK-u në veriun e Kosovës kishte tentuar ta lë një kohë të gjatë problem të heshtur, që u shndërrua në oazë të krimit dhe përfitimit të strukturave kriminale, të mbështetura nga politika e Beogradit.

Qeveria e Serbisë investoi legalisht dhe ilegalisht në këto struktura kriminale që të bëjnë presione të vazhdueshme mbi popullatën shqiptare për të pastruar etnikisht veriun e Kosovës. Kishte organizuar blerje të pronave të shqiptarëve në veri të Kosovës, përmes po të njëjtave strukturave kriminale, që sot kanë vendosur barrikada në rrugë. Falë vendosmërisë së banorëve të pjesës veriore për të qëndruar në vatrën e tyre, të cilët janë patriotë të vërtetë, bashkë me ata të cilët i ndihmuan dhe në vazhdimësi përkrahën banorët e pjesës veriore, plani i Serbisë për pastrimin etnik të asaj pjese dështoi.

Nuk e them këtë për ndonjë meritokraci, por ky plan i Serbisë nuk dështoi pse dikush fishkëllën a pështjellon, e rrokullis kamionë në jug, por për shkak se 5600 banorë shqiptarë që jetojnë sot në veri, u mbështetën dhe nuk u lanë vetëm në ditët shumë më të vështira se këto sot dhe nuk u përdorën për përfitime politike, siç ndodhë kohëve të fundit nga lideri i “Vetëvendosjes”, i cili një herë shkoi deri në çajtores të Samisë në

Lagjen e Boshnjakëve, që është në fillim të hyrjes së Mitrovicës dhe filloi me aktivistët e tij t'i akuzojë e përgojë të tjerët.

Është mirë që ne që kemi qenë me mijëra herë të bashkëqytetarët dhe familjarët tanë në veri, nuk kemi ndjekur logjikën e zotit Kurti, ngase veriu ka kërkuar unitet të veprimit dhe jo përçarje. Shikuar situatën nga prizmi real, prej se Partia Demokratike dhe Hashim Thaçi kanë ardhur në krye të qeverisjes, prej vitit 2008 kemi situatë të re të krijuar në veri të vendit. Për herë të parë, nga Qeveria e Kosovës investohet në atë pjesë, investime të cilat i potencoi i nderuari Kryeministri Thaçi, prandaj nuk po ua citoj ato.

Pas vitit 2008, është ndaluar shpërngulja e shqiptarëve nga veriu në jug dhe kemi kthimin për herë të parë të banorëve nga jugu në veri. Veprimi shumë legjitim i Qeverisë së Kosovës, me 25 korrik për vendosjen e sovranitetit në pikat 1 dhe 31, bashkë me profesionalizmin e lartë të njësive RSU, të mbështetura nga KFOR-i, bën që edhe dy kufijtë më verior të Kosovës të vendosen nën kontrollin e institucioneve shtetërore dhe të ndërpritet kontrabanda dhe kriminaliteti atje, andaj sot s'do mend se për këto veprime të Qeverisë, është normale që janë shqetësuar grupet kriminale që përfituan në veri, por pse po shqetësohen edhe disa në jug, është pak e pakuptueshme apo deri diku edhe mund të kuptohet. Sot në pikën 1 dhe 31 janë policët dhe doganierët e Republikës së Kosovës, të mbështetur nga EULEX-i e KFOR-i. Sot dihen qartë kufijtë e Kosovës, nuk ka grupe kriminale që mund ta sfidojnë KFOR-in edhe të cenojnë lirinë e lëvizjes. Opozita do të duhej të përshëndes koordinimin e shkëlqyer të Qeverisë së Kosovës me Bashkimin Evropian, SHBA- të, NATO-n dhe faktorët tjerë ndërkombëtarë për vendosjen e rendit dhe ligjin në veri, jo të bënte veprime adoleshente, joserioze dhe të acaronte raportet me ambasadorët e shteteve mike.

Kjo hipokrizi e disave nga opozita shkon deri aty që në këtë situatë, kur po vendoset sovraniteti në veri, ata kërkuar dorëheqjen e Qeverisë. Cili ishte qëllimi i një kërkesë të tillë politike? Që të prishet bashkërendimi i veprimeve me faktorin ndërkombëtar apo për të krijuar një vakum institucional në Kosovë që të blihet kohë për Serbinë dhe strukturat kriminale në veri, që të këndellen karshi situatës të palakueshme në të cilën ndodhen. Kur disa nacional-adoleshentëve iu bashkohen në kritika dhe ata të cilët ishin në pushtet para vitit 2008 dhe nuk bënë asgjë për veriun, vërtet është shqetësuese një mosmirënjohje e tillë për rezultatet e arritura në veri dhe seriozitetin e veprimeve të Qeverisë dhe të faktorëve ndërkombëtarë në atë pjesë.

Cilësia më e ulët e çdo individi në këtë botë, është mosmirënjohja dhe kur kjo bëhet në mënyrë institucionale, atëherë interesat shtetërore dëmtohen rëndë. Interesat shtetërore sot goditen në emër të nacionalizmit e patriotizmit. Kosova, shteti ynë njolloset dhe nuk njihet edhe nga pjesëtarët e këtij Parlamenti, të cilët përfaqësojnë një ideologji dhe politikë reaksionare, i cila vë interesa të veta të ngushta klasore mbi gjithçka, duke i paraqitur ato si interesa të gjithë kombit, pseudo patriotë të cilët as gripin e patriotizmit nuk e kanë kaluar.

Dhe, së fundi, jo me dëshirën time, por më bën të politizoj, por duhet t'i demantoj dy të pavërteta që Glauk Konjufca i tha më parë. Së pari, Bekim Shyti kurrë nuk ka qenë komandant i Zonës së Shalës, por i Njësisë Speciale në atë zonë, po ti Glauk këto nuk i njeh, nuk i di këto punë, por ke mund ta pyesësh kolegun tënd, zotin Rexhep Selimi, i cili në atë kohë ka qenë ministër i Punëve të Brendshme. Dhe, së dyti, ushtarët e UÇK-së, kanë pasur urdhër në atë kohë që t'i ruajnë objektet e rëndësishme së veçantë, institucionet shtetërore, fabrikat, institucionet publike dhe kurrë nuk kanë pasur e as që ka deklaruar zoti Shyti, një komandant i respektuar, një gjë të tillë, një të pavërtetë të cilën e the, por ti dhe do të partisë tënde në atë kohë keni ngarendur nëpër Prishtinë për të uzurpuar objekte dhe lokale, duke blerë uniforma nga 20 marka në atë kohë dhe për të uzurpuar apo për të ngarendur dhe për të bërë ndonjë raport te ndërkombëtarët me qëllim që t'ju punësojnë o juve, o ndonjërin nga familjarët e juaj në UNMIK. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti, nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Çështja për të cilën po bisedojmë ne, është çështje shumë e rëndësishme dhe shumë e vështirë, e cila ekziston 12 vjet dhe e cila është kthyer në fokus që tre muaj dhe ne këtë e dimë shumë mirë - pse. Nuk dua të bëj retorikë të tipit as partiak, as militant, as militar, sepse u panë ato shenja të njerëz të ndryshëm dhe besoj që janë shumë të padobishme. Më në fund, vetë kryeministri ka thënë disa herë që Partia Demokratike është ajo që ka dominuar qeverisjen e Kosovës deceniet e fundit dhe unë pajtohem me te, sepse vetë i ka dy mandate ose tri, sa po i bie, ndërsa të tjerët e kanë një, pak a shumë. Por, kjo s' më thotë mua diçka të veçantë në këtë rast, sepse desha të them që çështja e veriut të Kosovës nuk është një problem që do ta zgjidhë asnjë kryeministër, cilido qoftë këtu, sidomos jo nëse problemi personalizohet deri në nivelin - unë e bëj, unë s'e bëj. Është gabim shumë i madh dhe asnjë parti sepse, më në fund, në qeverisje demokratike edhe opozita nuk është në qeveri ekzekutive, po është pjesë e vendimmarrjes edhe as nuk mund t'i ikë për të mirë, as për të keq problemit, ashtu siç është Qeveria.

Pra, çështja u prek në disa segmente, nga disa diskutues, po unë për vete, që jam në këto banka në të gjitha legjislaturat e kësaj Kosove, e di që ky problem është artikuluar në këto banka që prej fillimit dhe kush ka qenë këtu atëherë, e mban mend, s'e mban mend, që kur Shtajneri i famshëm, administratori i parë këtu pas zgjedhjeve, ka ardhur me një rend pikash, nuk di a kanë qenë 10 a 12, çka të bëjë me veriun?

Pra, ka qenë gjithmonë një problem i pazgjidhur, një problem i koklavitur, i cili është me shumë shtresa dhe problemi është që kur diskutohet njëanshëm, secili e kap njërin shtresë, po i harron tjerat, qoftë opozitë, qoftë Qeveri, qoftë jetë civile, qytetare, qoftë raport me atë që quhen - miqtë tanë ndërkombëtarë. Prandaj, unë në histori nuk dua të hyj, unë vetëm po theksoj që edhe sot nga ky diskutim, edhe diskutimi në tre muajt e

fundit, që është më i intensifikuar për veriun, kjo është shumë e vërtetë, qoftë në diskutimet e brendshme, qoftë në kontaktet me të jashtmit, unë përsëris atë që kam thënë pak a shumë para 3 muajve - përkrah veprimin qeveritar të Kosovës, i cili provon, mundohet që ta shtrijë sovranitetin në gjithë territorin e Kosovës dhe këtë fjali e gjeni edhe atëherë, por po e përsëris edhe sot.

Mirëpo, ndodhitë kanë treguar që kjo nuk ka mund të ndodhë as për një ditë dhe nuk është punë e lehtë. Nuk është punë e një deklarimi të vullnetit kjo, është punë e forcës, raporteve, ndodhive, fuqisë, koordinimeve, sepse ne sot na intereson jo ç' ishte, por çka bëjmë sot për veriun? Kjo është esenciale. Dhe ç'është veriu i ashtuquajtur i Kosovës, a është problem i sundimit të ligjit, a është çështje e krimit të organizuar, a është çështje e sovranitetit, a është çështje politike? Është e të gjithave, unë e di që në diskutime për shkak të komoditetit të asaj që quhet komoditet i të folurit, pa përgjegjësi të mëdha, njeriu zgjedh njërën prej tyre, por është e gjitha, sepse unë mund të them që barrikadat që janë qitur në veri të Kosovës, nuk di sa janë me numra, po e di që janë shumë edhe ato janë lëvizëse, një prishet, një ndreqet, domethënë është njëfarë fizkulture e ushtruar e të ndërtuarit të barrikadave, bien ditën kur të sigurohet sovraniteti i Kosovës, të jeni të sigurt që bien vetë ato, të gjitha!

Pra, çështja e veriut po del që është në plan të parë çështje e sovranitetit. Është çështje e sundimit të ligjit, po, është moderne për të thënë këtë edhe është e vërtetë, sundimi i ligjit duhet të jetë kudo, por sundimin e ligjit Qeveria e Kosovës duhet ta provojë shumë më fort në jug të Ibrit. Ju thoni tash, ky, pse në jug të Ibrit? Thjeshtë, po e them në jug të Ibrit se – nëse ka pasur kontrabandë dhe krim të organizuar të tipit ekonomik, ata me banorë të Marsit s'e kanë bërë, por e kanë bërë me banorë të Kosovës që shkojnë deri te Ibri ose dalin ilegalisht a legalisht, a me qejf andej- këndej. Pra, kjo është universale sundimi i ligjit për çdo vend, edhe për Kosovën, por nuk lidhet me një komunë, nuk lidhet me një ta quajmë territor të ashtuquajtur të veçantë. Kështu që, edhe një herë po përsëris, prova e ICO- s , prova që të merret sovraniteti që të sundojë në gjithë territorin e Kosovës, është alfa dhe omega e krejt problemit të asaj që quhet veri ose Mitrovicë e veriut. S' kemi çka flasim as me zmadhime, as me zvogëlime.

Nëse kjo mbërrihet përmes veprimeve qeveritare, institucioneve të Kosovës dhe forcave, forcave tash po e them, në kuptimin e vërtetë të fjalës, që jam në Kosovë, qoftë ajo me emrin KFOR a EULEX, a Forcave të Sigurisë së Kosovës, a Policia e Kosovës, kjo nuk është me rëndësi dhe sigurohet kufiri, sovraniteti i Kosovës, çështja e veriut bëhet rrafsh si çështja e Prishtinës, si çështja e Lipjanit, e Shtërpçës, çështje e sundimit të ligjit, çështje e zhvillimit, çështje e komunikimit, e të drejtave të njeriut, të cilat janë të gjitha universale.

Pra, nëse ky territor universalizohet, e kjo ndodh vetëm me shtrirjen e sovranitetit të Kosovës në gjithë territorin e vet, atëherë problemi bëhet zhvillimor. Nuk bëhet zhvillimor problemi, pa ndodhur kjo, sepse nuk është problemi i atyre ne që po i quajmë struktura paralele, ata i quajnë normale, ne paralele, dikush i thotë janë kriminale, nuk është me rëndësi tash emri, cilësimi, problemi i tyre bëhet i

parëndësishëm në rast se ekziston sovraniteti i Kosovës, në rast se nuk kanë shans më të bëhen elemente përcaktuese shantazhuese të pavarësisë së Kosovës dhe të njohjes së saj. Tash për tash ato nuk janë struktura kriminele, janë politikë super e organizuar, e cila përdoret për shantazhim të sovranitetit të Kosovës dhe të njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni të filloj nga ajo që u fillua këtu në fillim, pra nga paraqitja e kryeministrit të Kosovës në fjalimin e tij, fjalim që më shumë i ngjante një fjalimi të Vitit të Ri, se sa një raporti para deputetëve të Kosovës për të raportuar për veriun dhe situatën e sigurisë atje.

Dhe, po ashtu, më lejoni të pajtohem qysh në fillim me kryeministrin kur tha që për datën 25 korrik, ka qenë kthesë vendimtare dhe unë e pranoj që ka qenë kthesë dhe po ashtu pranoj me mendimin e tij që thotë ka qenë vendim i domosdoshëm dhe si i tillë ka qenë vendim i domosdoshëm. Nuk pajtohem kur thotë që ka qenë vendim i menduar mirë, se sa i menduar mirë, tregoi data 26 e tutje.

Sidoqoftë, këtij vargu të fjalimit të kryeministrit iu lëshua mbrapa edhe përfaqësuesi i SLS-së, i cili bën thirrje për qetësi, i cili bën thirrje që të mos përdoret dhuna në shtetin e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht nuk bën thirrje për serbët e tij atje në veri që t'i heqin barrikadat.

Por, unë do të filloj nga konstatimi i gjendjes që me datën 25 korrik e deri më sot, sepse gjendja është më e thjeshtë se sa mundohet të dizajnohet këtu.

Aksioni i 25 korrikut, në fakt u përkrah nga gjithë spektri politik i Kosovës dhe po ashtu u përkrah edhe nga lëvizja “Vetëvendosje”, një përkrahje e pa rezervë për aksionin e Qeverisë së Kosovës në veri dhe për aksionin e Policisë së Kosovës atje. Dhe çka pastaj?

Megjithëse doli që ishte një aksion i pa analizuar mirë, ashtu edhe siç edhe vetë e pranojnë protagonistët e këtij aksioni kur thonë që ky aksion ishte i përgatitur për më pak se dy orë. Ky aksion rezultoi jo me një plan operacional, ky aksion rezultoi që policët e Kosovës atje ishin të pa pajisur në mënyrë adekuate dhe, si të tillë, ky aksion sidomos me urdhrin për të tërheqje edhe lëvizjet e pamenduara mirë, solli edhe vrasjen e policit të Kosovës, Heroit Enver Zymeri. Çka pas aksionit? Pas aksionit në veri kishte vetëm deklarata, asnjë aksion, asnjë akt, asnjë plan operacional.

Në fakt, një lloj plani operacional e ka sjellë Qeveria, po është një plan i cili i rekomandon KFOR-it, ku thotë: “KFOR-i do të operojë në pajtueshmëri me mandatin e tij dhe në kuadër të mundësive e aftësive të tij”. Ne e dimë që KFOR-i ka një plan, por ne po flasim këtu - cili është plani i Qeverisë. Ky plan operacional është një përmbledhje e sugjerimeve dhe këshillave për KFOR-in dhe për EULEX-in dhe jo një plan operacional.

Deklaratat tjera varg pas aksionit atje e kthyen Qeverinë në një fabrikë batutash bajate dhe këto batuta ju veç se i keni dëgjuar gjatë gjithë deklarimeve të tyre. Por, njëra ndër deklaratimet është se në veri u arrit qëllimi. Nëse konstatojmë që ky paska qenë qëllimi dhe është arritur qëllimi në veri, ne kemi të drejtën të mendojmë se qëllimi paska qenë i keq, sepse vetë situata në veri është shumë e keqe. Pastaj, përveç kaq, thuhet se plani operacional u bë më pak se sa dy orë, sepse përgjoheshin kryeministri dhe ministri i Brendshëm dhe nëse paska qenë kështu, kryeministri duhet të deklarohet se kush e përgjon atë, ministri duhet të deklarohet se kush e përgjon atë e jo të përdorë kesi frazash bajate dhe të “pa kripë”.

Pas këtij aksioni, ne dëgjuam edhe deklarata tjera që “nuk duam dhunë e gjak”! Edhe ne nuk duam dhunë e gjak, po është dikush tjetër atje që do dhunë e gjak dhe është dikush tjetër atje që ka derdhur gjak dhe ai është gjaku i policit të Kosovës, Heroit Enver Zymeri. Pra, është dikush tjetër që do gjak atje dhe ne kërkojmë që kjo gjakderdhje të ndalet.

Pra, gjendja e tanishme në veri është më keq se sa para datës 25 korrik. U tha dhe u konstatua këtu nga shumë kolegë dhe nuk ka nevojë të përsëritet. Por, unë mendoj që është edhe më keq se sa në qershor të vitit 1999. Ngjashmëria me veriuin me kohën e vitit 1999, është se atje në vitin 1999 kishte banda serbe, atje ka edhe sot banda serbe, por dallueshmëria është kjo, se në vitin 1999 bandat serbe kanë qenë duke ikur, kurse tash janë duke sulmuar shtetin dhe Republikën e Kosovës. Dhe, Qeveria çfarë bën, pret që të lodhen këto banda, Qeveria tërheq Policinë e Kosovës nga veriu, Qeveria numëron numrin e barrikadave në veri, Qeveria vetëm sa nuk thotë se po presim ne sa të lodhen, e pastaj ne të shkojmë në veri.

Dijeni se kriminelët nuk lodhen kurrë! Gjendja e tanishme në veri ka konstatuar në një situatë, ku atje janë dy palë, është Bashkësia Ndërkombëtare me prezencën e KFOR-it dhe të EULEX-it dhe janë institucionet ilegale serbe. Pra, Qeveria ka arritur të mos jetë pala atje dhe si e tillë është një vëzhguese nga Prishtina.

Ju keni kërkuar që opozita para se të kritikojë, duhet të ofrojë plane dhe ne u kemi ofruar një plan, një plan i cili parasheh shumë hapa të bashkërenditura për zgjidhjen e çështjes së veriut, një plan multidisiplinar. Një ndër këta hapa dhe jo të vetmit do të ishte që menjëherë të mbështetet që Forca e Sigurisë të Kosovës të bëhet ushtri partnere e denjë me KFOR-in dhe trupat e NATO-s atje.

Pastaj, përveç kaq, duhet të vihen në shënjestër burimet financiare të strukturave ilegale, që është bërë një kërkesë për këtë interpelancë. Përveç, këtyre pikave, ne duhet që atje të krijojmë një simetri të drejtë të serbëve në Kosovë dhe shqiptarëve në Luginën e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit dhe ne të reflektojmë me simetri me të drejtat e tyre që ju takojnë.

Pra, jo bisedime me Serbinë dhe strukturat e saj, por integritet territorial për vendin e sovranitetin për shtetin. Veriu nuk zgjidhet duke e respektuar Serbinë si shkaktare të

dhunës, por zgjidhet duke zbatuar dhe mbështetur Kushtetutën e Kosovës atje. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Shumë, shumë shkurt. Janë disa pyetje që rrjedhin prej bisedës sot. Fillimisht, kemi një qasje totalisht pasive të Qeverisë së Kosovës, e cila njihet se i atribuon vetvetes jo vetëm punët që i ka kryer dikush tjetër, por edhe punë që s'janë kryer hiq. Për t'ju dhënë një shembull, p.sh. Qeveria e Kosovës iu uron qytetarëve të Kosovës liberalizimin e vizave, që s'ka ndodh. Domethënë, i atribuon vetvetes jo vetëm punët që nuk i ka bërë vetë, por edhe punët që s'janë bë hiq. E ky atribuim lidhet drejtpërdrejt me propozimin të fitojë poena politikë prej diçkafit që nuk duhet të fitojë poenë politikë, por Kosova nuk po mundet ta gjejë mesin. Dikush nuk bën kurrigjë dhe atribuon vetës punë, dikush po lyp të bëjë më shumë se sa që mundemi. Edhe ndoshta i ka ardhur koha Kosovës ta gjejë mesin diqysh, se shumë po na del telashe me këto qëndrime edhe mendime të skajshme. Çështja tjetër, duhet ta sqarojë Qeveria e Kosovës këtu - reciprociteti. A ka qenë gabim kur e kanë vendosur, a ka qenë gabim kur e kanë hequr? Për shkak se situata nuk ka ndryshuar dhe meqenëse janë dy veprime të ndryshme të Qeverisë së Kosovës, në situatë të njëjtë nuk munden të dyja të jenë të mira, nuk munden të dyja të jenë të drejta dhe të vërteta.

Fillimisht, është vendosur edhe nja 3 vjet me vonesë, atë e udhëheq pa u ndryshuar qasja e Serbisë fare dhe po dua veç t'i pyes, le të na kallëzojnë - a kanë gabuar kur e kanë vendosur, çka po mendojnë këta, se unë e di çka kanë bërë, apo kanë gabuar kur e kanë hequr? Cili është gabimi, se njëri është gabim. Nuk munden të jenë dy veprime të ndryshme kontradiktore, të dyja të mira në situatë krejt të njëjtë. Vetëm kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë dhe i nderuari Kabinet qeveritar, në krye me kryeministrin, Mendoj se debati i sotëm ka rëndësi për arsye se trajtojmë një çështje me të cilën asnjë qytetar i Kosovës, për të cilën pra asnjë qytetarë i Kosovës nuk është indiferent. Edhe është mirë që herë pas herë, në harmoni me konkluzat që i kemi marrë, t'i kthehemi këtij problemi.

Unë po provoj të cek 3 çështje, të cilat sipas mendimit tim do të bënin më produktive zgjidhjen e këtij problemi. E para, nuk më duket se rrisim efektivitetin dhe produktivitetin edhe të Qeverisë, por edhe të institucioneve tjera, por edhe të këtij Kuvendi në qoftë se zgjidhjen e çështjes së veriut e shndërrojmë në një luftë politike midis forcave të ndryshme në Kuvend. Kjo është njëra nga çështjet kyçe nacionale, pra vendore në nivel të vendit, për zgjidhjen e të cilës duhet të arrihet një koncenzus minimal.

Kjo është një çështje njëra prej atyre 4-5 çështjeve, në të cilat ne duhet të kemi koncenzus nacional se si duhet t'i zgjidhim. Pra, në mënyrë që kjo çështje mos të

shndërrohet në një çështje të luftës së thjeshtë politike dhe ndërpartiake, atëherë natyrisht se duhet të bashkëveprohet më shumë dhe çështjen e bashkëveprimit kanë përgjegjësi ta iniciojnë të gjitha institucionet, duke filluar nga presidenti, nga kryeministri, nga ky Kuvend dhe nga të gjitha forcat politike. Pra, nevojitet bashkërendim dhe një bashkë koordinim që në këtë çështje të krijohet një koncensus minimal dhe një unitet i forcave politike në Kosovës. Nuk mendoj që është duke u vepruar sa duhet që këtu të arrihet një shkallë e domosdoshme e unitetit dhe evitimit të luftës ndërpartiake dhe tendencës që nëpërmes kësaj çështje të arrihen poenë politike, qoftë nga pozita, qoftë nga opozita.

Çështja e dytë, që nuk është duke u përdorur sa duhet dhe mendoj që do ta rriste produktivitetin e zgjidhjes së këtij problemi, ka të bëjë me reciprocitetin. Nëse ne kemi hyrë në dialog me Serbinë, pra nuk po bisedojmë për veriun, por i tërë dialogu tregon veriun dhe unë mendoj që nuk është mirë të bisedojmë për veriun dhe këtu mbështes të gjithë ata që angazhohen në këtë drejtim, mirëpo inferioriteti ynë në përdorimin e parimit të reciprocitetit po na bën jo produktiv, jo efektiv në zgjidhjen e problemeve.

Unë mendoj se zyrat e Kosovës u detyruan të pranohen për shkak të ushtrimit të reciprocitetit në tregti, jo për shkak të dëshirës së mirë, jo për shkak se hapëm dialog, por vulat e Kosovës u pranuan të përdoren disi për shkak se ishte reciprociteti dhe heqja e masës së reciprocitetit ende pa u zbatuar mirë marrëveshja, ende pa treguar pala tjetër e bisedave një seriozitet në zbatimin e marrëveshjeve, nuk është efektive.

Gjithashtu, unë nuk mund të di si mund të zhvillohet tregti e lirë midis dy vendeve, kur jemi plotë barrikada në 30% të territorit. Prandaj, mendoj që edhe Qeveria, por edhe të tjerët duhet bashkësisë ndërkombëtare t'ia shtrojnë këtë çështje, gjithashtu mendoj se duhet të insistojmë dhe t'ia bëjnë me dije edhe palës serbe se tregtia e lirë, masat e tregtisë së lirë nuk mund të zhvillohen me barrikada dhe se reciprociteti duhet të futet shumë shpejtë në qoftë se nuk hiqen barrikadat, për arsye se është krejtësisht e qartë dhe ministrat e Qeverisë serbe nuk po e fshehin se po inkurajojnë mbajtjen e barrikadave dhe po e mbështesin me logjistikën e tyre.

Çështja e tretë, e rritjes së produktivitetit në zgjidhjen e veriut, unë jam i bindur se ndërlidhet edhe me avancimin e proceseve të integrimit evropian. Në këtë drejtim, mendoj se ne më tepër duhet të bisedojmë me strukturat e Këshillit të Evropës dhe komisionet e Evropës, sepse unë kam përshtypjen që qasja e tyre në akselerimin e procesit të integrimit në Bashkësinë Evropiane të Serbisë dhe ngecjen e Kosovës, domethënë mbajtjen e Kosovës në një status - quo në këtë proces nuk është produktive dhe nuk e nxitë një atmosferë më të mirë të marrëdhënieve midis dy vendeve, por i konservon problemet, e konservon edhe problemin e veriut.

Mu për këtë, unë mendoj se ne duhet të kërkojmë që integrimi i Serbisë dhe i Kosovës dhe i tjera vendeve, si shtete me sovranitet brenda kufijve të ditur dhe të njohur, duhet të jetë i koordinuar, i harmonizuar, sepse avancimi i njërës palë dhe favorizimi i njërës palë nuk është produktiv për zgjedhjen e këtyre konflikteve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta. Agim, i ke 2 minuta, nëse i huazon, mund t'i marrësh edhe dy minuta!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Deputetë të nderuar,

Sot jemi këtu për të diskutuar ekskluzivisht për gjendjen në veriun e vendit dhe, në fakt, nuk ka çështje më të rëndësishme dhe që meriton këtë ekskluzivitet më shumë se kjo.

Në këtë rast, i dhimbshëm është fakti që pikërisht duke qenë çështja më e ndjeshme, çështja e veriut nga forcat politike është shndërruar në një lum për peshkimin e kredive patriotike. Për më keq, patriotizmi nuk është i barasvlershëm me gjetjen e zgjidhjes së vërtetë të problemit, por me problematizimin sa më të madh të zgjidhjes. Kjo ka bërë që premisa mbi të cilën ndërtohen vazhdimisht diskutimet mbi veriun, të jetë e gabueshme, rrjedhimisht edhe vendimet e pazbatueshme.

Në fakt, si Qeveria, ashtu edhe subjekti iniciues i këtij mocioni janë në pajtim të plotë sa i përket klasifikimit të këtij problemi. Që të dyja e shohin si çështje të shtrirjes së autoritetit, si çështje e shtrirjes së rendit dhe ligjit edhe në atë pjesë. Dallimi qëndron në aspektin e zbatueshmërisë së projektit në përputhje me këto qasje. Në fakt, sot kemi një grupim politik që mburret me atë çka ai e quan atë sukses të ndërhyrjes, dhe një grupim tjetër, që akuzon për atë që e quan mungesë vullneti e guximi për vazhdimin e ndërhyrjes së filluar.

E vërteta është se problemi nuk është te çështja e ndërhyrjes së suksesshme apo të ndërprerë, problemi është se vetë ndërhyrja nuk është zgjidhje. Edhe ndërhyrja më e suksesshme në përputhje me misionin që po vendoset, është dështim, sepse problemi është te misioni. Nuk po përcaktohet si mision zgjidhja e problemit themelor shqiptaro-serb, por shtrirja e autoritetit në veri, që me vetë faktin që po synohet të bëhet dhunshëm, nuk nënkupton zgjidhje.

Serbia ka pasur autoritet të plotë të dhunshëm mbi Kosovën për një shekull, por kurrë nuk ka arritur të na detyrojë t'i nënshtrohemi këtij autoriteti. Përfundimisht, Kosova nuk ka problem me serbët e veriut, për veriun, por ka problem me Serbinë për veriun e Kosovës dhe Kosovën Lindore. Pra, ky nuk është një problem i thjeshtë teknik dhe i sigurisë, por është një problem i thellë politik, prandaj edhe do qasje në zgjidhje të tillë.

Natyra e këtyre mocioneve, pavarësisht kërkesës së drejtë për ndërprerjen e bisedimeve teknike, nuk e ofron këtë. Kështu, duke qenë se rezolutën e paradokohshme për veriun e kemi konsideruar si veprim të papjekur dhe të rrezikshëm për shkak të pasojave të cilat edhe rrodhën, e me të cilat po ballafaqohemi edhe sot, ne si Lëvizje për Bashkim kemi pasur qëndrim "kundër". Sot, kur situata është edhe më e qartë, e aq më tepër kur kemi involvim direkt të një faktori ushtarak, siç është KFOR-i, që ka autoritet suprem në fushën e sigurisë në Kosovë, kërkesën për ndërhyrjen e Policisë së Kosovës e konsiderojnë edhe të pakuptimtë. Prandaj, lidhur me këtë pikë ne nuk do të votojmë fare! Faleminderit, për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni që duke përshëndetur, zonja dhe zotërinj deputetë, juve të gjithëve, edhe ju kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra, të përshëndes edhe këtë debat!

Është mirë kur debatohen çështje të tilla në Kuvend dhe jo aq mirë kur këto pastaj barten jashtë Kuvendit. Është një çështje me interes të përbashkët dhe do të duhej edhe të reflektohej në një qasje të përbashkët. Është synim i përbashkët dhe shqetësim i përbashkët. Pavarësisht se ndonjëherë sforcohen, po të shikohen me kujdes, dallimet janë kryesisht të natyrës strategjike, taktike, dallime rreth metodave dhe rrugëve, rreth dinamikës, por jo rreth synimit që është i përbashkët.

Janë edhe kontradiktat si të tilla, jo antagoniste, që edhe duhet të zgjidhen me debat si ky që po e zhvillojnë këtu. Nuk na duhen sot as veprime dhe as oponencë me prapavijë përfitimeve politike ose materiale. Është një fjalë e urtë e popullit, që thotë: “sa më shpesh matesh, aq më lehtë vjen”. I duhet sot Kosovës mbështetje e përbashkët të gjitha përpjekjeve, madje edhe atyre që nuk kanë rezultuar gjithmonë me sukses, por kanë qenë të motivuara pozitivisht në angazhimin e përbashkët.

Theksimi eventual i mangësive, lëshimeve, dobësimeve e gabimeve që janë të pashmangshme në procese të tilla, duhet të jenë në funksion të korrigjimit dhe të konsolidimit dhe jo të pritjes në pritë të tjetrit kur po gabon dhe kur po më vjen në shteg. Me lejen tuaj, unë do të theksoj vetëm ndonjë nga pyetjet që shtrohen gjithandej kur trajtohen këto çështje edhe në biseda, edhe në shkrime, me shpresë që ato mund të jenë edhe në funksion të konsolidimit të pozicionit tonë, përsëri të përbashkët.

Shtrohet me të drejtë pyetja gjithandej - a është injoruar gjatë gjendja në veri dhe vetë problemi i atjeshëm? A është bërë sa duhet për ndryshime thelbësore në këtë pjesë të Kosovës? A është shtrirë sa e si duhet realiteti i ri edhe në këtë pjesë të Kosovës? A është punuar sa duhet në ndryshimin e perceptimit në këtë pjesë të Kosovës për realitetin e ri dhe për synimet që përfshijnë edhe të ardhmen e tyre prosperuese etj? A kemi bërë sa duhet për të dalluar Serbinë dhe politikën e saj nga serbët e Kosovës dhe interesat e tyre të vërteta? A ka ndikuar ndonjëherë dhe a ka pasur efekte kundërprodhuese edhe një diskurs i vjetruar me tone që i kemi parë ndonjëherë prej armiqve tanë? A kanë ndikuar në këtë gjendje në veri edhe qasja festive, triumfaliste ndaj dokumentit të Ahtisarit, pa përmendur edhe raste të ngjashme dhe krijimi i përshtypjes sikur një palë është e stërkënaqur dhe po feston, dhe një palë është e dëmtuar shumë dhe po ankohet, edhe pse edhe vetë zoti Ahtisari ka thënë se është një dokument, një propozim i dhimbshëm, një kompromis i dhimbshëm edhe për shumicën shqiptare.

A ka pasur ndikim në këtë gjendje cilësimi në vazhdimësi i strukturave të vjetra të regjimit millosheviqian, si struktura paralele, duke pasur parasysh edhe përvojën pozitive me një emërtim të tillë edhe në zhvillimet politike në Kosovë? A ka ndikuar në trimërimin e strukturave të vjetra të ish-regjimit të Millosheviqit, pranimi dialogut me Serbinë jo gjithmonë vetëm për çështje teknike, por për çështjet që me çdo kriter janë dhe

s'mund të mos cilësohen si çështje të brendshme të Kosovës dhe, rrjedhimisht, të panegociueshme, siç janë vlerësuar edhe nga ky Kuvend, madje pa kërkuar prej Beogradit asnjë akt të vullnetit të mirë, që është e zakonshme t'i paraprinë proceseve të tilla.

A e ka lehtësuar krijimin e kësaj gjendje injorimi i çështjes së pazgjidhur të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës? Injorimi i gjendjes së krijuar atje madje edhe me spastrim etnik, siç është rasti në Medvegjë. A i ka kontribuar krijimit edhe të tablosë komplete për zhvillimet në këtë pjesë, edhe në sy të opinionit ndërkombëtar, amplifikimi i problemeve në një pjesë dhe injorimi në një pjesë tjetër dhe a i ndihmon kësaj vazhdimi i heshtjes së çështjes së pazgjidhur ende dhe shumë nevralgjike të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës? Një fjalë e popullit thotë: "pyka e nxjerr pykën"!

Zonja dhe zotërinj,

Unë s'kam kohë të shtrohem më shumë eventualisht në përgjigjet në këto pyetje, por besoj se përgjigjet janë vetë brenda pyetjeve. Besoj se përgjigjet adekuate, konstruktive në këto dhe pyetje si këto, mund të ndihmojnë në konsolidimin e pozicionit tonë, i cili pastaj në bashkëpunim me partnerët tanë, të cilët s'mund mos t'i falënderojmë, s'mund mos i mbështesim në përpjekjet që bëjnë, por në mënyrë komplementare edhe do të mund të arrinim të bënim edhe ndryshimet e synuara bashkërisht. Uroj edhe që të ndodhë kështu! Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj për minutat që i kanë grupet parlamentare: Partisë Demokratike, pas këtij diskutimi i mbesin edhe 20 minuta, Lidhja Demokratike i ka edhe 25 minuta, "Vetëvendosja" i ka 6 minuta, Aleanca i ka 7 minuta, AKR-ja i ka 3 minuta, për të tjerët më duket s'paska të interesuar, përveç ndonjë të pavaruri. Vazhdojmë!

Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Ne tani sot po diskutojmë për të satën herë prapë për një temë tejet të rëndësishme, që është veriu i Kosovës.

Nuk do shumë kohë dhe shumë analizë për një konstatim, i cili gjithmonë me të drejtë është konstatuar se qëndron pa asnjë dilemë. Gjendja në veri është tejet e keqe, atje kemi të bëjmë me një ambient, i cili terrorizon qytetarët atje. Atje kemi një ambient, ku definitivisht shantazhohen misionet ndërkombëtare, po shantazhohen edhe të gjitha ambiciet edhe përpjekjet e institucioneve të Republikës së Kosovës për ta ndryshuar gjendjen atje.

Nuk do të kishim dëshiruar që nga sot në një të ardhme të konstatojmë atë që sot mund të konstatojmë se cilat ishin rezultatet e një qasje dhe e një administrimi çfarë ishte atje, në atë pjesë të Kosovës për 8 a 9 vjetët sa UNMIK-u ishte në administrim. Unë them se rezultatet janë tejet të vogla. Më kujtohet shumë mirë sa herë që kemi insistuar që të

diskutojmë atje, përgjigjja thuaja ka qenë gjithmonë e njëjta: “Ju punoni punët e juaja në Prishtinë, se ne jemi këtu dhe ne do ta kryejmë punën tonë”.

Ndërsa, pas diskutimeve paksa më detale, ka dalë se ne jemi këtu të sigurojmë një stabilitet dhe kjo është ambicia jonë. Dhe është ambicia për sundim ligji, ambicia për integritet, ambicia për realizimin e barazisë së qytetarëve dhe të drejtës qytetarëve në kthimin e pronave të tyre, e drejta e qytetarëve që të zgjedhin për perspektivën e tyre gjithmonë ka qenë sekondare. Dhe, definitivisht, ai stabilitet ka qenë me çmimin që ne sot po e paguajmë të gjithë, pra dhe institucionet dhe qytetarët e Kosovës, kudo dhe këtu në Prishtinë, por edhe atje në atë pjesë të Kosovës, pra kudo që është.

Kjo, gjithmonë i ka përngjarë, ai stabilitet për të cilin unë tash fola, i ka përngjarë sikur të mbahet temperatura e ujit nën ndikimin e temperaturave të larta. Pra, ngase rreziku latent për destabilizim ka ekzistuar gjithmonë, ngase asnjëherë nuk janë marrë me motivet e asaj situate... pak a shumë një menaxhim të përkohshëm për ta rregulluar komoditetin e qeverisjes, pra komoditetin e administrimit derisa ishin aty. Prandaj, këtë drejtim që kjo të mos përsëritet, edhe njëherë duhet të përkujtojmë që për të mundur të lëvizë përpara secili sipas obligimeve edhe përgjegjësi që ka, duhet të krijohet një ambient, pra duhet të krijojmë parakushte që secili të mund të kryej detyrat e veta atje.

Jemi në mbështetje të plotë të misionit të KFOR-it që atje të sigurohet, pra vetë siguria, liria e lëvizjes edhe gjithçka çka shkon me misionin e KFOR-it. Po ashtu, kërkojmë një rritje të sundimit të ligjit, pra që bie në misionin e EULEX-it dhe të kompetencave të policisë. Po ashtu, nganjëherë jemi të befasuar edhe përkundër deklarimeve pozitive që vijnë që nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pastaj zonja Merkel dhe deklaratimet e tjera, por nganjëherë jemi të zhgënjyer edhe me disa deklaratime të disa diplomatëve, të cilët sikur nuk e dinë se cila është situata në veri, të cilët vazhdimisht e ushqejnë ambicien e Serbisë e cila sillet ngase ka ndryshuar mjetet, nuk e ka policinë, nuk e ka ushtrinë, nuk e bën gjenocidin dhe terrorin që e ka bërë në Kosovë, mirëpo udhëhiqet nga e njëjta ambicie që është udhëhequr edhe politika e Millosheviqit, deri dje. Dhe, thirret për një kompromis dhe thirret për dialog, sikur kanë harruar se Kosova ka kaluar nëpër dialog, statusi i Kosovës ka kaluar nëpër dialog, Serbia ka qenë në tavolinën e dialogut dhe të definimit, pra të statusit.

Kosovarët nuk e kanë përzgjedhur pakon e Ahtisarit, Kushtetutën dhe ligjet pozitive që i kanë. Ajo ka dalë pikërisht nga një bisedim, nga një dialog. Por, loja jo e para e Serbisë, që do të sillen kështu, kjo është mirë, ka ardhur deri këtu, por unë do ta refuzoj se do të provoj të bëj një kompromis, më tutje. Dhe, i përngjanë, këto thirrje pra të disa diplomatëve, i përngjajnë stilit që ai i cili “lazdrohet” bën një kompromis, jepi diçka “më shumë”. Por, kjo “më shumë” po del shumë e dëmshme, prandaj do t’i kundërshtojmë të gjitha këto deklaratime, ngase një prej problemeve kryesore që pastaj derivojnë pasojat për të cilat po flas, sepse sundimi i ligjit është pasojë, nuk është shkak. Pastaj, terroret që ju bëhen të gjithë atyre që mendojnë ndryshe, prapë është pasojë, por shkak është interferimi i Beogradit me strukturat që ka, pastaj krimi i organizuar edhe ngritja e disa individëve mbi politikë, pra si një para politikë dhe mbi politikë, pikërisht duke e shfrytëzuar pasurinë që e ka krijuar nga krimi i organizuar.

Dhe, arsyetimet e disa diplomatëve se ekziston vullneti i Beogradit, por aty tani gjendja ka dal nga kontrolli, të themi, janë totalisht të papranueshme, ngase pikërisht Beogradi e ka stimuluar këtë dalje të kontrollit, ngase edhe tani e tute udhëhiqet jo nga një projekt, jo nga një vizion për të tejkaluar situatën, por thjeshtë udhëhiqet nga fuqia që e ka ndërtuar për ta shantazhuar jetën në përgjithësi, por edhe progresin që duhet ta shënojë Kosova në atë pjesë.

Është pa precedencë dhe është e pakuptueshme që tani edhe nëpër tavolinat e disa diplomatëve ndodhen diskutimet e faktorizimit të disa liderëve atje, të cilët kanë shkuar përtej çdo standardi jo të kualitetit të jetës, jo të barazisë qytetare, jo të mundësive të barabarta dhe të perspektivës së përbashkët, vlera këto kudo dominonte, por e drejta e një komune që të vetëvendosin se në cilin shtet do të jetojë. Kjo është anakronia më e madhe që ndodh dhe këtë shembull nuk e heton, nuk e sheh askund, sepse po të instalohet, do të thotë ky parim diku, kush po i pyet qytetarët që janë të një entiteti tjetër qoftë Sanxhak, Preshevë, Vojvodinë apo në Mal të Zi, apo në Maqedoni e kudo se cila komunë ku do të jetojë, atëherë do të ishte krijuar një kaos në rendin botëror në përgjithësi, sidomos këtu në Ballkan.

Prandaj, ata liderë nuk duhet fare të pranohen në tavolinë me këto ide. Unë nuk jam kundër që të bisedohet me cilindo faktor, jo në cilësinë e një personi legal, përkundër një legjitimiteti që e kanë mbërri. Por, assesi në cilësinë e faktorëve, të cilët pastaj kushtëzojnë edhe në të drejtat elementare, siç është liria e lëvizjes, që neve po na ndodh këto ditë. Prandaj, ne inkurajojmë edhe njëherë që ne të bëjmë detyrat e tona, që KFOR-i të vazhdojë, diplomacia ndërkombëtare ta bëjë punën e vet, të bëjë presion dhe më në fund nga Beogradi të kërkojë sjellje të ndryshme, jo deklarime të ndryshme. Të kërkojë nga Beogradi definitivisht që të sqarohet se dëshiron të ketë një qasje ndryshe, dëshiron të dallohet nga një e kaluar dhe dëshiron që më në fund, me emër dhe mbiemër, shumë saktësisht të përcaktojë politikat e veta, por jo të shantazhojë Kosovën, jo të shantazhojë jetën e qytetarëve dhe jo të stimulojë terrorin që po ndodh atje, të gjithë atyre që mendojnë ndryshe.

Të gjithë ata që kanë pas rastin të kenë përgjegjësi dhe obligime në raport me veriu, kanë parë mirëfilltë se sa i madh është numri i qytetarëve, pikërisht edhe të komunitetit të nacionalitetit serb që është i pakënaqur me atë mënyrë të jetës. Sa i madh është qytetari i cili thotë se “unë do të bashkëpunoj me gjithë ata që më sigurojnë barazi, që më sigurojnë perspektivë, që më sigurojnë mirëqenie”, por çka ndodh me ata? Posa të kthehen e gjejnë një koktej molotov, e gjejnë një bombë, një atentat, një diferencim, një largim nga puna të anëtarëve të familjes.

Prandaj, është e domosdoshme, pra, krahas kësaj klime dhe këtyre parakushteve që po bisedojmë, rritja e sundimit të ligjit dhe në këtë drejtim ne inkurajojmë EULEX-in që të mos dështojë dhe ta implementojë një mision tejet të rëndësishëm, jo vetëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, por në përgjithësi edhe për fuqinë e Bashkimit Evropian në tërësi. Ndërsa, inkurajojmë edhe Qeverinë e Kosovës që shumë shpejt të dal; edhe me plan veprimi deri në detale. Unë ju siguroj, si njohës i asaj pjese, se qytetarët janë shumë

pak të informuar, por edhe shumë pak kanë informata nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Cila është mënyra që qytetarët në atë pjesë të marrin informacione? Cili televizion që kishte për të përçuar fjalën e institucioneve dhe të shoqërisë kosovare në tërësi, funksionon atje, cili medium, qoftë elektronik apo ai i shkruar? Domethënë, ne nuk jemi prezentë fare as me një informatë të cilën në formën më të lehtë do ta kishim dërguar atje dhe sigurisht që qytetarët, qoftë nga kureshtja dhe nga interesi do ta kishin përcjellë atje dhe do të kishte mundur të zvogëlohet ai indoktrinimi se ekzistojnë atje qytetarë që mendojnë se kjo ambicie për kthimin e Kosovës në kuadër të Serbisë apo ambicia e ndarjeve është diçka patriotike.

Ndërsa, definitivisht ne duhet t'ju bëjmë me dije atje, Kosova asnjëherë nuk do të diskutojë për çështjen e ndarjes, asnjëherë nuk do të diskutojë për një voluntarizëm të një komune që do të përcaktojë dhe do të shantazhojë se si do të jetojë ajo. Ajo duhet të respektojë ligjin, duhet të respektojë normat më elementare, ndërsa vullnetin e tij politik ai mund ta mbajë. Ne kemi aq numër të madh të qytetarëve me të cilët ne mund të kontraktojmë dhe mund ta qojmë projektin tonë përpara.

Duhet shumë shpejtë të ndërtojmë komunikime direkte, pra, me ata qytetarë të cilët vërtet janë në një udhëkryq. Duhet të ndikohet te bashkësia ndërkombëtare që jo me mjete të bashkësisë ndërkombëtare Beogradi të financojë atë formë të jetës që atje momentalisht ekziston. Duhet shumë shpejtë të bëhet riorganizimi i administratës...

(Ndërprerje regjia)

KRYETARI: Hajde, edhe 1 minutë vazhdo!

SADRI FERATI: Po, pikërisht që Qeveria i bën këto, por unë dëshiroj që ky proces të jetë i rëndësishëm, s'është vetëm detyrim dhe përkushtim i Qeverisë, por i gjithë shoqërisë kosovare, pra edhe i imi personalisht, edhe i grupit parlamentar që e përfaqësoj. Dhe, duhet pra shumë shpejtë që atje të mbështetet jeta e qytetarëve, sidomos në meset multietnike.

Një pjesë e madhe e qytetarëve nuk e di çka është Kodra e Minatorëve, një pjesë e madhe e qytetarëve nuk e di se atje edhe po të sëmuret njeriu, deri në mëngjes ose duhet të lutet që të mos vdes, ose duhet të vdes me gajret, se atje nuk shkon kurrkush t'u ofrojë ndihmë, pra edhe në këtë drejtim të bëhet më shumë. Njëkohësisht, të mbështeten qytetarët të cilët pa fajin e tyre nuk kanë qasje në pronat e tyre, të mbështeten të gjitha iniciativat e shoqërisë civile dhe të tjera, të cilët stimulojnë komunikimin në mes qytetarëve dhe të cilët stimulojnë bashkëjetesën, të mbështeten ato biznese, posaçërisht ato biznese të cilat përveç që ndikojnë në zhvillim, ndikojnë edhe në mundësitë e barabarta dhe në mundësinë që njerëzit, pavarësisht nga dallimet e tyre...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

(Ndërhyrje)

Është mirë që të merreni vesh në grupe. Kohën me qëllim ju tregova sa, tash p.sh. prej 25 minutave, Lidhjes Demokratike i mbetën 14 minuta. Fjalën e ka deputetja Alma Lama, ju tregoj që ju i keni 6 minuta. Nëse i merr 3 minuta, lë pjesë për 3 minuta për kryetarin e grupit.

ALMA LAMA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Shumë gjëra u thanë këtu për situatën në veri dhe nuk dua të përsëris atë që kam thënë edhe më herët për aksionin e 25 korrikut, i cili për mua ka qenë një aventurë e Qeverisë me pasoja tragjike. Ajo që unë dua të nënvizoj, është se në veri nuk kemi të bëjmë thjeshtë me një pa dëgjueshmëri qytetare, por me dhunë dhe pengim të lirisë së lëvizjes, garantuar kjo me Kushtetutën e Kosovës dhe me deklaratën universale të të drejtave të njeriut, si dhe me pengim të funksionimit të shtetit. Është kjo arsyeja, sepse nuk ka nevojë që të zhvillohen negociata me njerëzit që e thyjnë ligjin, pasi me krimin nuk negociohet. Kur kjo bëhet, dëmtohet e drejta si koncept juridik, por edhe moral, pasi ajo nuk vjen më në plotni, por e zbehët dhe pse jo - fragmentare. Tamam ashtu siç po ndodh në veri, me barrikada që bllokojnë rrugët dhe shtigjet, që gjoja hapen vetëm për KFOR-in.

E meqë jemi te KFOR-i, duhet thënë qartë se autoriteti i tyre po sfidohet si kurrë më parë. Unë jam e bindur se KFOR-i nuk do ta humbas durimin dhe të gjejë ndonjë zgjidhje e cila buron prej humbjes së durimit, sepse janë më të mençur se kaq, por kërkoj nga Qeveria e Kosovës që të mos e humb durimin e të bëjë ndonjë marrëzi, si p.sh. të pranojë idenë e dialogut politik për këtë pjesë, ide e cila po sillet vërdallë.

Duhet ta kemi të qartë se trupat e KFOR-it në veri kanë nevojë për ndihmën tonë, për ndihmën e politikës dhe të vetë qytetarëve. Unë kam bindjen se ruajtja e qetësisë, matura dhe kuptimi i drejtë i situatës atje është ndihma më e mirë që mund t'i jepet KFOR-it. Sa për Qeverinë, ajo nuk ka ndonjë rol në veri, përveç faktit që lëshon deklarata mëngjes, drekë, darkë.

Por, është e rëndësishme që të fillojë të mendojë si Qeveri, e jo si spektatore, siç po bën tani realisht, pasi kjo do të ketë pasoja të rënda për rolin e saj në të ardhmen atje. Duhet ta kemi gjithashtu të qartë se barrikadimi në radhë të parë dëmton serbët që jetojnë në veri dhe se kjo situatë, nëse zgjat, do të sjell largimin e një pjese të tyre. Pra, kryetarët e paligjshëm të komunave atje dhe të strukturave kriminale që i mbështesin, do të ndikojnë në vetë spastrimin etnik dhe Qeveria e Kosovës duhet të dijë se ku ta drejtojë gishtin për këtë.

E fundit që dua të them është kjo: këtu në Kuvendin e Kosovës kemi një numër të madh përfaqësuesish të komunitetit serbë, madje janë edhe pjesë e koalicionit qeveritar, pjesa më e madhe. Edhe pse janë pjesë e institucioneve të Kosovës, edhe pse kanë përfitur nga

zemërgjerësia e shumicës këtu, nuk i kam dëgjuar deri tani të distancohen nga veprimet e dhunshme të serbëve në veri. Këtë madje nuk e bëri as përfaqësuesi i SLS-së, i cili sapo foli më parë.

I vetmi distancim nga këto veprime ka ardhur nga një subjekt politik në Serbi, Partia Liberale e Qedomir Jovanoviqit, qëndrimi i të cilit është për t'u përshëndetur pasi është i drejtë dhe i guximshëm, besoj, për realitetin atje. Mendoj se edhe komuniteti serb në Kosovë ka nevojë për liderë vizionarë, të cilët e kuptojnë se dhuna dhe urrejtja ndëretnike nuk i çon askund. Mjafton ta hedhin vështrimin në të shkuarën, se nuk mund të marrin vetëm të mirat që ofron shteti i Kosovës, por duhet edhe të kontribuojnë për ndërtimin e tij dhe se heshtja për veprimet e paligjshme është aprovim. Ndaj, zoti kryetar i Kuvendit, unë ju bëj thirrje kolegëve serbë të dalin me qëndrime të qarta për situatën në veri.

Një gjë tjetër që dua të them, është ajo që e tha kryeministri kur akuzoi UNMIK-un, i cili nuk vendosi sundimin e ligjit, i cili sipas tij e ka shkelur mandatin e tij dhe ka vepruar në mënyrë jo transparente dhe në këtë mënyrë ka ndihmuar Beogradin për të krijuar këtë situatë që e kemi sot. Të gjitha janë këto të vërteta, por unë dua ta pyes kryeministrin se pse këto akuza nuk i bëri gjatë asaj kohe, por i thotë tani si "koshi pas të vjelave". Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj- Bujupi. Donikë, i keni 7 minuta gjithsej, nëse do t'i ndash, ndaj me Ahmetin!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë,
Përfaqësues të Qeverisë,
Qëndrimi indiferent në raport me veriun nga faktori vendor dhe ndërkombëtar, ndaj situatës anarkike atje, ka favorizuar krimin dhe kriminelët dhe ka pamundësuar rrjedhën normale të jetës së qytetarëve atje dhe problemet rrjedhimisht janë thelluar.

Cilat kanë qenë arsyet e ngecjes dhe mungesës së veprimeve? A është ndonjë skemë apo kalkulim ekonomik kriminal i Qeverisë së Kosovës, unë nuk do të diskutoj sot dhe jo për shkak të Qeverisë, por për shkak të njerëzve atje dhe për shkak të Mitrovicës, sepse konsideroj që gjendja në të cilën është veriu, kërkon një angazhim të gjithë faktorit vendor dhe ndërkombëtar dhe s'na lejon ndarje. 26 korriku e ka treguar gatishmërinë e gjithë spektrit politik që të përkrahë Qeverinë në veprimet e veta, mirëpo Qeveria ka dështuar në këto veprime, sepse nuk ka shfrytëzuar mekanizmat e shtetit që janë edhe obligim kushtetues që të shtrijë sovranitetin dhe integritetin kushtetues atje. Përveç kësaj, sot pas këtij dështimi, kryeministri del me një fjalim irracional, i cili na lë një përshtypje që Mitrovica, në fakt në Mitrovicë është bërë shumë. Është e kundërta, në Mitrovicë është bërë pak dhe duhet bërë shumë më shumë.

Më lejoni që edhe njëherë të ritheksoj ato që i thanë kolegët e mi të Aleancës. Do të thotë, 3 vjet më parë Aleanca ka kërkuar që të kemi një gjithëpërfshirje për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës. Një agjendë gjithëpërfshirëse dhe veprimet e koordinuara institucionale në të gjithë sektorët dhe kjo nuk nënkupton ndërtimin e 3 shtëpive, qysh tha kryeministri më parë në fjalimin e tij. Nënkupton një plan zhvillimor që do të zbuste

varfërinë dhe papunësinë. Më kujtohet shumë mirë që gjatë fushatës shumë herë është thënë që “ e kemi të gatshëm planin për zhvillimin ekonomik të Mitrovicës”. A mundeni të na tregoni se ku mbeti ai plan? Besoj që nuk keni menduar për një ujësjellës, të cilin e tha kryeministri në fjalimin e tij.

Pastaj, një sektor tjetër shumë i rëndësishëm, ku Aleanca kërkon që të investohet, është shëndetësia. Është domosdoshmëri që të investohet në përmirësimin e infrastrukturës, përkrahjen e personelit shëndetësor, stimulimin shtesë qoftë përmes diskriminimit pozitiv të atyre punonjësve, sepse punojnë në kushte dhe specifika të ndryshme. Ministria e Arsimit të fokusohet më shumë në investime kapitale dhe atë në zonat e pa integruara, po e rritet, dhe këtu nuk bëhet fjalë për ndërtimin e një shkolle ose 2 shkollave, duhet shumë e shumë se kaq. Ministria e Infrastrukturës dhe dikasteret e tjerë veç e veç të kenë në prioritet dhe plan konkret rimëkëmbjen e qytetit të Mitrovicës.

Një shqetësim tjetër që sot po iu ndodh banorëve atje, është edhe keqpërdorimi shumë i madh i grave dhe i fëmijëve që po bëhet nga strukturat kriminale, kryesisht për përfitimet e veta ekonomike dhe politike, nuk u përmend këtu, këta njerëz duhet të trajtohen. Duhet të shohim se qytetarët e izoluar të fshatrave Koshtovë, Qabrat, Zhash dhe Boletin kanë nevojë për një përkujdesje institucionale të menjëhershme edhe sot jemi vonë. Kanë kaluar 3 muaj që është ndërmarrë një veprim dhe ata njerëz kanë mbetur në mëshirën e fatit. Në përgjithësi, derisa ne këtu flasim dhe debatojmë, qytetarët e kësaj ane janë lënë në mëshirë të fatit dhe në mëshirë të kriminelëve. Janë lënë në varfëri, të papunë, madje edhe rryma, të nderuar kolegë deputetë, ndalet më shumë se në cilindo qytet tjetër, pikërisht në Mitrovicë. Duke marrë parasysh që ata jetojnë në një pasiguri shumë të madhe, ky është edhe një problem shtesë.

Dhe, krejt për fund, nuk është kohë fushate, prandaj nuk është mirë që të tregohemi pseudopatriot ose të flasim për të fituar vota. Unë e ftoj Qeverinë e Kosovës që të zbres pak nga lartësitë e pushtetit, të shkojë dhe të jetë prezente në Mitrovicë me të gjitha mekanizmat e shtetit të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar Krasniqi!

Sa për t’i kontribuar pak debatit dhe duke ju falënderuar për diskutimet tuaja, në të njëjtën kohë dëshiroj që për hir të transparencës t’ju informoj edhe juve, ju jeni të informuar, por t’i informoj gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se vetëm për këtë vit Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të rimëkëmbjes së Mitrovicës është duke investuar rreth 41.000.000 euro. Është 23.000.000 euro projekti për sallën e sporteve, parku, shtëpia e kulturës, qendra e qytetit, së bashku me Komisionin Evropian, 23.000.000 euro! Pastaj, fabrika për prodhimin e ujit 13.000.000 euro, rrjeti primar i ujësjellësit 5.000.000 euro, vetëm këto 3 projekte bëjnë 41.000.000 euro.

Vitin e ardhshëm fillon ndërtimi i 2 universiteteve, Universiteti Ndërkombëtar Multietnik dhe ndërtimi i objektit të fakulteteve aktuale, që do të bëhet nga viti i ardhshëm Universiteti i Mitrovicës. Përmenda vetëm këto 3 projekte prej 41.000.000 euro, duke

mos përfshirë investimet tjera drejtpërdrejtë edhe përmes autoriteteve komunale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Donika, replikë!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, shumë!

I nderuar kryetar,

Desha t'i them kryeministrit që fatmirësisht që Mitrovica në këtë rast ka qenë, sa i përket këtyre prioritetëve ka qenë në listën e prioritetëve për Bashkimin Evropian, të cilët edhe i kanë ndarë këto fonde. Sa iu përket juve, si Qeveri e Republikës së Kosovës, përveç një shtëpie ose dy shtëpive, për të cilat po vazhdoni të mburreni, ne nuk po shohim që keni punuar, ndërtuar dhe investuar ose të paktën se di kur keni qenë për herë të fundit në Mitrovicë, t'i pyesni njerëzit atje se cila është gjendja e tyre atje dhe a ka bërë mjaft Qeveria e Kosovës?

Me këtë çka po e thoni ju, ky optimizëm i juaj i tepruar me të vërtetë është shqetësues edhe për ata që po ju përcjellin, nëse kanë rrymë nga Mitrovica.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Emin Gërbeshi, 3 minuat i ka.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ka kohë që ne kemi biseduar për situatën në veri dhe ka kohë që kemi shprehur mendime, kemi dhënë ide se si duhet të zgjidhet problemi i veriut të Kosovës.

Por, mendimi im është se situata në pjesën veriore të Kosovës nuk do të ndryshojë derisa Serbia ka qasje të tillë dhe ka pretendime që ta aneksojë këtë pjesë të territorit të shtetit të Kosovës dhe se derisa ajo financon strukturat paralele të Serbisë atje, derisa ajo vazhdimisht pretendon që ajo pjesë t'i shkëputet Kosovës.

Mendoj se Qeveria e Kosovës ka bërë hapa konkretë, por duhet të vazhdojë me këmbëngulje përpjekjet e saja për të vendosur rendin dhe ligjin në atë pjesë të Kosovës. Mendoj se hapat konkretë duhet të jenë shumë më të vendosur. Koha tashmë është që të rishikohet edhe njëherë çështja e bisedimeve me Serbinë se a duhet të vazhdojmë apo jo dhe unë mendoj që nuk duhet të vazhdojmë, derisa Serbia përkrah strukturat paralele atje, financon kriminalitetin, financon bandat kriminale.

Mendoj se është shumë e paarsyeshme që në njërën anë atakohet sovraniteti i Kosovës dhe në anën tjetër qindra kamionë serbë me mallra hyjnë në territorin e Kosovës dhe qindra milionë euro nga Kosova shkojnë për Serbi. Edhe kjo mendoj se nuk është politikë që i kontribuon situatës në veri. Qasja jonë duhet të jetë shumë më konkrete, duhet të kemi vendime shumë më të guximshme për t'i qar proceset përpara, madje Qeveria duhet të ulet dhe të hartojë një strategji të re për të zgjidhur këtë problem.

Pa dhënë kushte paraprake, nuk besoj se do të ketë zgjidhje të problemit të veriut të Kosovës. Ne e dimë që me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, ne kemi bërë atë që duhet ta bëjmë si shtet, por përpjekjet tona për ta vënë gjithë sovranitetin dhe gjithë rendin dhe ligjin në gjithë Kosovën, kanë dështuar. Prandaj, përpjekja duhet të jetë shumë më këmbëngulëse se sa që ka qenë deri më sot dhe janë këto dy kushte parësore që patjetër duhet t'i vihen Serbisë, nëse ajo dëshiron të integrohet.

Ne kemi dëshmuar se jemi për integritet, ne kemi dëshmuar se jemi për të ruajtur stabilitetin në Ballkan, për të krijuar një fqinjësi të mirë, për të vazhduar një fqinjësi të mirë me të gjitha shtetet përreth, por megjithatë Serbia ka vazhduar me politikën e saj të vjetër që në njëfarë mënyre ne e kemi toleruar tej mase. Tash është koha që të marrim vendime, dy janë ato kryesoret, vendosja e embargos përsëri ndaj Serbisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Vjosë Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qytetarët të Republikës së Kosovës janë lodhur në njërën anë me krekosjen dhe deklaratimet pompoze të Qeverisë se veriun po ia kthejnë vendit dhe, në anën tjetër, me thirrjet për luftë dhe hyrje të dhunshme në atë pjesë.

Por, qytetarët tanë në veri janë lodhur shumëfish më shumë, shumëfish më shumë nga të qenit të pasigurt. Kodra e Minatorëve, 3 Rrokaqiejt. Lagjia e Boshnjakëve, Bistrica, Cerraja, Kushtova, Kroji i Vitakut dhe vendbanimet tjera me shqiptarë, që fatkeqësisht tani kanë mbetur të pakta në numër, janë tërësisht të pambrojtur dhe ju rrezikohet jeta në baza ditore.

Qeveria thotë, se ka kthim të shqiptarëve në veri, por fatkeqësisht numri i atyre që po largohen çdo ditë është shumëfish më i madh. Ata kërkojnë investime në sigurinë e tyre, sepse investimi në disa rrugë dhe ujësjellës nuk u siguron atyre së paku një natë pa roje para shtëpisë apo një ditë pa frikë për jetën e tyre. Ata jetojnë në ankth të vazhdueshëm pa kurrfarë përkrahjeje institucionale. Është jo serioze nga ana e institucioneve kur një këshilltar i kryeministrit, që pikërisht merret me fushën e sigurisë, propozon të formohet ministri për veriun, duke denigruar vetvetiu sovranitetin e Kosovës në atë pjesë.

Zgjerimi dhe rritja e Qeverisë në numra nuk do të garantojë sigurinë e shqiptarëve në veri. Siguria e qytetarëve duhet të jetë prioritet kryesor dhe duhet të bazohet në plane konkrete dhe garantim të të drejtave elementare, atë për të jetuar të lirë dhe pa frikë. Kjo mund të arrihet vetëm kur të arrestohen udhëheqësit e krimit multietnik, të cilëve iu ka konvencuar dhe po vazhdon t'u konvencojë mungesa e sovranitetit në veri. Kjo arrihet vetëm atëherë kur Qeveria flet njëzëri për këtë çështje, e jo si tani, kur kemi një kakofoni qëndrimesh, ku ministrat deklarojnë diçka, këshilltarët diçka tjetër, zëvendëskryeministrat tjetër.

Ky jo seriozitet reflektohet edhe tek siguria e qytetarëve në veri, të cilët nuk dinë se kujt t'i besojnë dhe humbin çdo ditë edhe më shumë besimin tek institucionet e Republikës së Kosovës.

Qeveria duhet të sigurohet se ka një plan për ngritjen e nivelit të sigurisë së shqiptarëve në veri, por përveç kësaj edhe plan konkret për rimëkëmbjen ekonomike të shqiptarëve që nuk përfshinë vetëm investimet kapitale.

Serbia deri sot ka harxhuar më shumë se 6 miliardë euro vetëm në veri të Kosovës, prandaj Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje maksimale që të ketë kushte më të mira dhe stimulime për qytetarët shqiptarë në veri.

Dinamika e heqjes së barrikadave dhe shtrirjes së sovranitetit në veri duhet të rritet domosdo. Sa më pasive dhe të ngadalshme veprimet, aq më shumë kohë kanë kriminelët serbë për përforcimin e barrikadave që çdo ditë e më shumë po e marrin formën e mureve ndarëse të cilat, deshëm s'deshëm, na i përkujtojnë rastet e tjera në histori.

Qeveria kurrësi nuk duhet ta luajë rolin e spektatorit. Me 25 korrik, sipas Komisionit Evropian dhe vlerësimeve të tyre, Qeveria intervenoi pa koordinim ndërkombëtar, kurse tash po punon vetëm KFOR-i dhe Qeveria po shikon pa luajtur ndonjë rol, edhe pse flitet për sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Me këtë rol të spektatorit, natyrisht që po lejon që faktor kryesor të bëhen strukturat kriminale në veri, të cilat si duket po bëhen të vetmit të cilët po pyeten për atë pjesë të Kosovës.

Mos shtrirja e sovranitetit fatkeqësisht po ndikon edhe në procesin e njohjes së Kosovës dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Ta përmend një shembull. Kosova këto ditë po bën përpjekje maksimale për anëtarësim në Organizatën Ndërkombëtare të Doganave apo OBD-në dhe po pritet që diçka të ndodhë këtë dhjetor, por fatkeqësisht problemet me doganat në veri po e vështirësojnë një proces të tillë, sepse parakusht është që Kosova të jetë territor unik doganor edhe në praktikë, e jo vetëm në letër.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kur Lidhja Demokratike e Kosovës, para se të fillojë dialogu me Serbinë, deklaroi se Kosova kategorikisht duhet të kërkojë shuarjen e strukturave kriminale, si kusht për fillimin e dialogut, Qeverisë i ngutej që të hipte në avion për Bruksel.

Tani, duke e vazhduar këtë dialog, përkundër faktit se Serbia po shkel integritetin territorial të Kosovës çdo ditë, Qeveria po krijon çdo ditë e më shumë dyshime tek qytetarët se ky jo seriozitet do të rezultojë me futjen e temës së veriut në procesin e bisedimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri! I keni në dispozicion dy minutë, Visar!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Kryeministri nuk qenka këtu, po ai e përmendi pak më parë në deklarinimin e tij të dytë në këtë seancë se po investuaka Qeveria e Kosovës gjithsej 41 milionë euro tash në Mitrovicë, 23 prej të cilëve, mos gabofsha, tha që do të shkojnë në pallatin e kulturës, pallatin e sporteve dhe në parkun në Mitrovicë. Pra, kjo është shumë mirë, se vërtet qytetarët e Mitrovicës e lëshojnë Mitrovicën, e lëshojnë se s'kanë ku të luajnë futboll. Ky është problemi kryesor i tyre, sipas kryeministrit.

Investimet e mirëfillta në rivitalizimin ekonomik të Mitrovicës, ne e dimë të gjithë cilat janë. Pa Trepçën, nuk ka zhvillim ekonomik as të Kosovës, as të Mitrovicës, por kjo Qeveri nuk po bën asgjë për Trepçën dhe a e dini pse nuk po bën? Për shkak se kjo Qeveri e ka ndërmend ta shes Trepçën. Pra, e ka ndërmend të shkatërrojë edhe më tutje ekonominë, edhe të Mitrovicës, edhe të Kosovës, e jo ta zhvillojë atë. Këtë nuk po e thonë për shkak se e dinë që është keq, por megjithatë këtë po e veprojnë, duke e ditur se është keq.

Natyrisht që pjesa veriore e Kosovës është problem politik. Mirëpo, pjesa veriore e Kosovës, problemi politik atje na shpërfaqet edhe si problem shumë i madh ekonomik. Pra, këtu u fol disa herë për masat e reciprocitetit të cilat kjo Qeveri i mori dhe tash të cilat i hoqi. Pra, me masat e reciprocitetit u dëshmuua, sikur me intervenimin e policisë më 25 korrik, se Kosova po mundka, i paska kapacitetet, mirëpo ja që po dështon politikisht. Se kur u morën masat e reciprocitetit, u pa që Kosova mund të jetojë pa mallrat e Serbisë, madje – madje jetonim shumë më mirë, për shkak se prodhuesit e Kosovës filluan që të hapin sytë dhe filluan që të ngjallen në prodhimin e tyre, meqenëse u hap hapësira në treg. Mirëpo, kjo Qeveri çka bëri, shkoj edhe ua ngushtoi atë hapësirë pikërisht në momentin kur ata filluan të dalin publikisht dhe të thonë se tash i kemi punët më mirë, se po shesim më shumë dhe po punësojmë më shumë njerëz. Dhe Qeveria e Kosovës, kryeministri Hashim Thaçi tha - e po s'keni për të punësuar më shumë, nuk keni për të shitur më shumë, se tash unë e bie Serbinë prapë këtu! Pra, kjo ishte porosia e tyre dhe ky është edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, Visar! E ke harxhuar kohën! Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi. Ahmet, në dispozicion i ke 3 minuta!

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ne dëgjuam sot një fjalim moralizues për vendimin dhe vendimi tek ka qenë i drejtë, është përkrahur nga të gjithë, nga partitë politike, nga institucionet, nga qytetarët, nga bashkësia ndërkombëtare, nga të gjithë, sepse ka qenë i drejtë, s'ka nevojë për të na përsëritur.

Cila është dashur të jetë rruga për një raport? Është dashur të thuhet, ne e kemi bërë që nga 25 korriku këtë veprim, këtë veprim, këtë veprim, këtë veprim! Jemi duke u përgatitur ta bëjmë këtë, këtë, këtë dhe ky është plani i Qeverisë.

Këtu s'kemi kurrfarë plani konkret mbi të cilin mund të thirret. Është një dokument, është e vërtetë, siç ka qenë edhe strategjia, që ka mbetur në letër, dhe kurrgjë tjetër nuk ka.

Tash flitet për lirinë e lëvizjes, për pavarësinë, për sovranitetin, për veprimet të cilat në fakt është dashur t'i bëjë Qeveria konform interesave të qytetarëve të Kosovës, pa dallim, dhe në të njëjtën kohë thuhet - do t'i ndjekim kriminelët. Po kriminelët po dalin para kamerave, janë te barrikadat të cilat i kanë vendosur, sepse vendosja e barrikadës dhe moslejimi i lëvizjes së lirë është krim, është vepër penale, është cenim i të drejtës së lëvizjes së qytetarëve, prandaj këtë duhet ta bëjë si veprim edhe Qeveria e Kosovës, e cila thotë është plan i imi, nuk po thotë që është plan i KFOR-it, as i EULEX-it, po plan i imi në bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in.

Nëse është plan i Qeverisë së Kosovës, duhet zbatuar nga Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me mekanizmat të cilët, në fakt, i kemi përkrahur në vazhdimësi.

Objektivat institucionale të Kosovës duhet të jenë, jo për të treguar që kanë investuar në një fshat të komunës së veriut, po plan konkret mbi gjithë territorin e Republikës së Kosovës për të vepruar si institucione të Kosovës, pa asnjë dallim, sepse po e konsideron territor tëndin, qytetarët tutë dhe ke për obligim t'i përmbushësh objektivat institucionale qeveritare.

Dhe, një gjë duhet ta kemi të qartë. Atje qytetarët janë zënë peng. Nëse kriminelët i paskan zënë peng ata qytetarë, absolutisht duhet veprim i institucioneve tona, në bashkëpunim me ato ndërkombëtare, që kriminelët të cilët dalin edhe para televizorit dhe tregojnë që vetë po i vendosin barrikadat, ta kryejnë obligimin institucional shtetëror dhe të burgosen. Ata nuk janë diku në mal, e po lypin, kur ata po iu dalin para kamerave dhe para hundëve të EULEX-it, të KFOR-it, të institucioneve tona.

Dhe, po ashtu, mund të them se dy vendime që janë marrë në këtë Kuvend, janë marrë që të vijnë të raportojnë, të raportojnë mbi veprimet, jo mbi një fjalor patriotik që të na...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, Ahmet! Fjalën e ka deputeti Idriz Vehapi!

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Problemi i veriut të Kosovës duhet të vështrohet nga këndi i kapaciteteve dhe fuqisë politike të Kosovës, në njërën anë, si dhe nga fuqia e presionit dhe e shantazhit politik që i bëhet shtetit të Kosovës nga shteti serb brenda, por edhe para bashkësisë ndërkombëtare, nga ana tjetër.

Këtë shantazh Serbia po e provon përpos me rrugë të tjera, edhe me aktivizimin dhe fuqizimin e strukturave paralele në veri. Kështu, duke parapëlqyer politikat e konfuzionit, politika zyrtare serbe herë bëhet se i kontrollon këto struktura, herë vihet në mbrojtje të tyre me idenë se janë struktura me autonomi të plotë vendimmarrëse, e herë-herë bën një shmangie të kursit të saj politik me gjëja presionin që iu vë këtyre strukturave për të zhbllokuar rrugët, si në rastin e fundit, duke dalë tash me një konsensus dinak - lejinin e vetëm të forcave të KFOR-it në veri.

Kjo lojë dykuptimëshe e gjuhës dhe e veprimeve politike të Serbisë është e projektuar të përfitojë nga çfarëdo situatë e rrethane, edhe kur mund të pasojnë të tilla situata të projektuara nga politika serbe për të provokuar qëndrime të bashkësisë ndërkombëtare në favor të saj, por që papritur dalin si të dëmshme nga faktori ndërkombëtar. Pra, Serbia kërkon ta kurthojë edhe Kosovën në kurthin e politikës së saj.

Radikalizimi i fundit i serbëve, i gjatë edhe në kohë edhe vetëtensionues po aq, domethënë 14 javë janë që i mbajnë rrugët e bllokuara në veri të Kosovës, pretendon të bindë faktorin ndërkombëtar se nuk bën hiq të shkohet më tutje pa u realizuar kërkesat e tyre, se nuk mund të ketë qetësi në Kosovë as edhe një minutë pa u plotësuar objektivat e tyre.

Duke u shfrytëzuar taktika në dëm të politikës së brendshme të Kosovës dhe të përfitimit për aderim të Serbisë në BE, liderët ilegalë po zgjasin agoninë e bllokimit të rrugëve duke përfituar në kohë nga këndvështrimi i fundit për ndarje fizike të Kosovës. Pra, problemi i veriut kërkohet nëpërmjet një politike që avancojnë në trajtë riciklimin e dhunës.

Këto politika të Beogradit janë minuese për projektet integruese e civilizuese. Kjo jotolerancë dhe dhunë sistematike e strukturave paralele serbe të veriut ka krijuar sistemin dhe infrastrukturën e vet nga një oportunitet i strukturave të UNMIK-ut që ka vepruar e po vepron ende në Kosovë pa instanca kontrolluese e të përgjegjësishë, që nuk e di njeriu kah dhe pse u është lejuar të zhvillojnë politika të tilla kompromisi me strukturat kriminale. Nuk mund të identifikosh asnjë provë serioze të UNMIK-ut që të ketë provuar ndonjëherë seriozisht me plan dhe në mënyrë sistematike për integrimin e qytetit të ndarë të Mitrovicës, as për kërkesën elementare madje për krijimin e kushteve për lëvizje të lirë, diçka që kurrë seriozisht nuk është provuar, as për krijimin e një perspektive të qartë për të gjithë, diçka që po ashtu kurrë nuk është provuar.

Pra deri këtu e tash UNMIK-u nuk ka provuar bash hiq krijimin e një hapësire për qarkullim të lirë dhe për një perspektivë dinjitoze për qytetarët e veriut.

Në këtë thellim të problemeve u ka dalë shumë punë institucioneve të Kosovës. Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in po bën përpjekje që të vendosë sigurinë e plotë në gjithë Kosovën, ku duhet të sundojë rendi dhe ligji dhe të ketë lëvizje të lirë të qytetarëve, si një e drejtë fundamentale.

Të nderuar deputetë,

Kosova nuk ka ofertë tjetër, si asnjë qeveri e saj nuk do të ketë, pos mirëkuptimin për të realizuar planin e Ahtisarit, si një ofertë afatgjatë, si partner e bashkudhëtar në rrugën e përbashkët të integriteteve evropiane.

Qeveria e Kosovës është duke u angazhuar për të siguruar aspektin individual e etnik të sigurisë së serbëve, të cilët të vetëdijshëm për rolin si dhe garancitë që kanë fituar nga institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare nuk do të duhej të ndjeheshin kurrë të cenuar e as të privuar nga realizimi i të drejtave të tyre të plota si populli shumicë shqiptar.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se në këtë kontekst qasjet e Qeverisë kanë ecur në këtë drejtim, duke u orientuar e provuar kapacitetet e saj muaj pas muaji e vit pas viti për të dhënë prova konstante të vullnetit të mirë e të përkushtimit, si një ndër mënyrat për prodhim të sigurisë, zhvillim të mirëqenies, si dhe krijim të mekanizmave modernë institucionalë që garantojnë sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.

Kreativiteti i këtyre politikave ndihmohet edhe nga qasja jonë përkushtuese në këtë Kuvend për këtë çështje, pozitë e opozitë, me idenë për të mos përkrahur zhvillimin e debateve mohuese veç në një rrafsh se kinse Qeveria s'po bën asgjë për integritetin e veriut dhe kinse këtë do ta bënte dikush shumë shpejt dhe mirë. Nuk po e them këtë për të ngacmuar reagim, por për të jetuar bashkë përkushtimin tonë se nga politikat e praktikat mohuese që janë pjesë e frustrimeve njerëzore, që shfityrojnë përpjekjet e mbara, do të duhej të orientojnë kohën tonë kah qasjet racionale e inventive si Qeveri, si grupime deputetësh e subjekteve politike apo edhe si deputetë me përgjegjësi individuale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Anton Quni, e ka fjalën!

ANTON ÇUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Për 13 vite regjimi i Beogradit investimet më të mëdha i ka fokusuar në veriun e Kosovës, e determinuar nga faktorët demografikë dhe gjeografikë. Për ta mbajtur nën kontroll këtë pjesë të territorit të Kosovës, ajo tërheqjen e forcave policore ushtarake e kompensoi me ngritjen e forcave jo konvencionale, paramilitare, kriminale, shërbime inteligjente, qeverisje lokale, parti ultra-nacionaliste e tjera.

Për këtë kohë, duke shfrytëzuar hezitimin e autoriteteve të UNMIK-ut, kapacitetet e kufizuara të Republikës së Kosovës, ngriti dhe instaloi një infrastrukturë të fuqishme e cila ka për detyrë që t'i përgjigjet çfarëdo skenari nëse tentohet nga Qeveria e Kosovës apo e autoriteteve ndërkombëtare që edhe në atë pjesë të shtrihet sundimi i ligjit dhe funksionalizimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për më shumë se një dekadë në veri bashkëjetojnë krimi dhe politika zyrtare e Beogradit, duke financuar dhe mbështetur njëra-tjetrën në forma të ndryshme. Për fat të keq, këtij

ambienti iu bashkëngjitën edhe disa kriminelë shqip-folës, duke e komplikuar edhe më tej situatën.

Veriu u bë çerdhe e kontrabandës, trafikimit me narkotikë dhe qenie njerëzore, shpëlarjes së parave, vrasjeve enigmatike, reketimit, dhunës, shantazhimit dhe frikësimit të bashkëkombësve të vetë. Të gjitha këto në emër të kauzës kombëtare serbe.

Për ta mbajtur këtë gjendje, politika e Beogradit nëpërmjet shërbimeve të inteligjencës, ushtarake dhe civile, dhe me ndihmën e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë ngriti formacione të armatosura të strukturuar mirë, me disiplinë dhe përgjegjësi ushtarako-police, ngriti struktura ilegale të qeverisjes lokale dhe këtë pjesë të territorit e vuri nën kontroll të plotë.

Një situatë e tillë asnjëherë nga autoritetet e Kosovës nuk u adresua siç duhet për ta definuar këtë situatë se a kemi të bëjmë me okupim të një pjese të territorit, aneksim, shkëputje apo ndonjë situatë të panjohur deri tani në qarqet diplomatike. Kur një situatë është e pa definuar, atëherë edhe qasja ndaj asaj situatë është improvizim, irracionale, politike ditore, të cilat mund të prodhojnë efekte të paparashikuara.

Problemi i veriut është aq kompleks që të angazhohet vetëm Policia e Kosovës për zgjedhjen e saj, është si të kërkosh nga ata zgjedhjen e nyjës së Gordianit me sy të mbyllur. Aleksandri i Madh e zgjodhi këtë problem me goditjen e shpatës. Për momentin, këtë forcë në Kosovë e ka vetëm organizata më e fuqishme politiko-ushtarake NATO, kështu që vetëm me koordinim dhe bashkërenditje të mirë me forcat e NATO-s dhe mirëkuptim e bashkëpunim të mirë me mekanizmat e bashkësisë evropiane mund të presim rezultate pozitive.

Forcat e NATO-s dhe mekanizmat e BE-së nuk do të qëndrojnë në Kosovë në pafundësi, kurse Serbia do të jetë fqinji ynë i përjetshëm dhe varësisht nga momentet, do të shfaqë appetite ndaj territoreve të Kosovës. Prandaj, që nga sot Qeveria e Kosovës me prioritetin më të lartë duhet të përqendrohet në ngritjen e të gjitha komponentëve të sigurisë me kapacitete të plota, profesionale, bashkëkohore, apartiake dhe kompatible njëra me tjetrën dhe mekanizmat ndërkombëtarë, të afta për operacione sado komplekse, në kohë dhe hapësirë. Në ndërkohë, me mundësitë që i kanë të qëndrojnë në gatishmëri për asistencë trupave të KFOR-it dhe Policisë së EULEX-it.

Në rrethana të tilla, është e domosdoshme ngritja e besueshmërisë ndaj miqve dhe partnerëve tanë, se jemi seriozisht të përkushtuar për ndërtimin e shtetit ligjor, me nivel të lartë të sigurisë, me perspektivë të zhvillimit ekonomik, arsimor e tjera, në bazë të normave dhe vlerave demokratike, si garanci për të gjithë qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti! Ju të Partisë Demokratike i keni edhe 14 minuta, Lidhja Demokratike i ka edhe 6 minuta.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, anëtarë të kabinetit,
S'do mend se ky ishte një rast i mirë për të trajtuar një nga çështjet më delikate të sigurisë së vendit, një nga çështjet më delikate jo vetëm të sigurisë, por të rrjedhave në vend.

Megjithatë, unë personalisht mendoj se çështje të tilla duhet me kujdes të trajtohen dhe gjithnjë në frymën sa më konstruktive dhe jo në komunikim elektorale dhe sidomos gjatë transmetimeve, meqenëse u përmend nga disa deputetë edhe televizioni, edhe komunikimi me televizionin sot.

Sot më shumë se të gjithë, pati rast Qeveria e vendit, kryeministri që para nesh dhe para qytetarëve të Kosovës të prezantojë vizionin politik për trajtimin e çështjeve të tilla të ndjeshme për vendin dhe po ashtu të heqë dilemat se mund të ketë shmangie nga rruga e kujdesshme dhe njëkohësisht e vendosur për të eliminuar vështirësitë që dalin para nesh.

Unë sot, më shumë se kurrë do të prisja që të shtroheshin çështje që kanë të bëjnë më pas kësaj situatë. Dhe, pyetja do të ishte, më shumë se sa ato dilema që ndoshta janë normale për ata që s'i kanë informacionet se çfarë shteti paskëshim ndërtuar, e tjera, sepse edhe këto dilema e çojnë procesin përpara, dhe në fund të fundit këto janë dilema të cilat i shtynë proceset përpara, por jo dilema në nivelin e gjendjes së skepticizmit, sikur i kishin disa institucione mbështetëse para nesh, e pse jo edhe UNMIK-u, të cilat e kanë zhagitur ose zvarritur situatën dhe zgjidhjen e kësaj situatë me vite të tëra.

Po, pyetja do të ishte: Çka pas barrikadave, ose çka pas heqjes së barrikadave?

Unë mendoj se këtu do të shtrohej krejt, do të ishte mirë të shtrohej fokusi i interesimit të institucioneve, po pse jo vetëm i institucioneve, por edhe i shoqërisë në përgjithësi. Çka pas heqjes së barrikadave? A do të ketë liri të plotë, a do të bëhet angazhimi në masë të njëjtë për lirinë e të gjithë qytetarëve, a do të ketë vazhdim të luftimit të krimit, a do të ketë vazhdim edhe më të madh të investimeve, a do të ketë integrim të gjithë qytetarëve në jetën publike, e tjera. Dhe, përveç tjerash, a do të sigurohen, a do të ketë shtim të angazhimit të institucioneve për sundimin e plotë të ligjit, të sundimit të rendit dhe ligjit?

Në një prej angazhimeve të mia para 3 vitesh, në një tryezë pata thënë atëherë me bagazhin e përfaqësuesit të Qeverisë se ne nuk do të bëjmë asnjëherë atë që e kanë bërë të tjerët ndaj nesh. Ne asnjëherë nuk do të sillemi ndaj komunitetit pakicë ashtu siç janë sjellë të tjerët ndaj nesh. Dhe një nga komentet më pastaj nga miqtë e mi ishte se – jo të gjithë përfaqësuesit politikë kanë përgjegjësinë, kanë kredibilitetin që të mund të japin deklarata të tilla. Më besoni se gjatë gjithë punës sime kam pas këtë dilemë dhe unë mendoj që edhe sot kur ngriten çështje të tilla të rëndësishme për vendin tonë do të duhej të kemi kujdesin më të madh se si do t'i shtrojmë ato dhe si duhet të sillemi ndaj tyre.

Megjithatë, unë mendoj që Qeveria e vendit duhet të vazhdojë t'i trajtojë qytetarët serbë në veri si qytetarë të Republikës së Kosovës dhe me aq përgjegjësi do të sillej ndaj gjithë qytetarëve pa dallim, edhe të shqiptarëve, edhe të atyre serbëve që sot ende ndihen të manipuluar nga politika e Beogradit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju njoftoj se nga Lidhja Demokratike s'ka të lajmëruar! Nga partitë tjera, grupet parlamentare do s'janë lajmëruar, do i kanë harxhuar fjalët. Nga Partia Demokratike janë edhe 7, kanë kohë 10 minuta, por ndoshta ato duhet t'i rezervojnë për kryeministrin, po mund t'ia japim edhe njërit fjalën, dhe po shkojmë sipas renditjes që e kemi, Ramiz Lladrovci e ka fjalën!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ekzistimi i strukturave paralele pengon shtrirjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe nga ky vakum kanë përfutur grupet e krimit të organizuar, duke realizuar fitime të mëdha materiale dhe ndikim politik në qytetarët serbë të veriut.

Këto grupe janë të stilit të klanit të Zemunit dhe si të tilla ato paraqesin kërcënim jo vetëm për stabilitetin në Kosovë, por edhe për forcat demokratike në Serbi dhe rajon.

Ju e dini që raste kaq delikate, të ndjeshme dhe të pa kompromis kanë viktimizuar madje edhe deri te zyrtarë më të lartë të Serbisë, siç është rasti i kryeministrit Gjingjic.

Veprimet e fundit të Qeverisë, KFOR-it dhe EULEX-it në veri janë në funksion të sigurisë, rendit dhe ligjit për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të qytetarëve që jetojnë atje. Ne duhet të besojmë në përkushtimin e Qeverisë, të KFOR-it dhe EULEX-it në angazhimet e tyre për t'i hequr barrikadat e dhunshme dhe për t'u mundësuar lëvizje të lirë të gjithë qytetarëve.

Që nga pas lufta e deri më sot, roli i pranisë ndërkombëtare mbetet po thuaj se përcaktues në zhvillimin e sektorit të sigurisë në veri, e me këtë edhe në vendosjen dhe forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit në Kosovë.

Duke pasur parasysh dominimin e një situate të tillë, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Zyrën Ndërkombëtare Civile në Kosovë hartoi strategjinë për veriuin e Kosovës, janë pajtuar për pakon e Ahtisarit, strategji e cila qartëson politikat qeveritare në raport me veriuin. Synimi i kësaj strategjie është krijimi dhe forcimi i institucioneve të zbatimit të ligjit në gjithë territorin e Kosovës, si dhe krijimin e mekanizmave të qeverisjes, përmirësimin e situatës ekonomike atje. Por nuk duhet të kemi iluzione se një gjendje e krijuar me vite të tëra mund të zgjidhet vetëm në pakë javë. E rëndësishme është se gjendja e status-kuos ka marrë fund dhe kjo çështje e ndjeshme është futur në rrugën e zgjidhjes. Andaj, më mirë një zgjidhje e kujdesshme dhe e vonuar në kohë, por e pa kompromis në llogari të territorit tonë.

Gjendja në veri nuk u përmirësua në terren ende, por diplomatikisht pozita e Kosovës në raport me veriuin u fuqizua shumë pas 25 korrikut, me marrëveshjen për vulat doganore më 2 shtator dhe kushtëzimet e Serbisë nga Berlioni dhe Brukseli. Ne kemi besim të plotë se KFOR-i do t'i heqë shpejt këto barrikada dhe nuk do të lejojë të poshtërohet para strukturave paralele dhe liderëve të tyre në veri.

Unifikimi i qëndrimit të BE-së në lidhje me doganën, në pikat kufitare 1 dhe 31 është arritje e madhe për të cilën kemi pritur 3 vjet. Kosova nuk duhet të humbë durimin mu në momentin kur po ndodh një pikë kthimi shumë i rëndësishëm. Duhet t'i mirëkuptojmë taktikat e KFOR-it që nuk ka përdorur forcë ende, por që është e përgatitur po qe se ajo duhet.

Deri më tani KFOR vetëm iu ka treguar forcë serbëve për t'i shtyrë ata të negociojnë seriozisht. Paralelisht me aktivitetin e KFOR-it për krijimin e kushteve për qarkullim të lirë të qytetarëve, duhet të veprojë kundrejt krimit dhe klaneve mafioze edhe EULEX-i, përmes task-forcës së krijuar në nëntor të vitit 2010 mu për këtë qëllim.

Për kryeministrin, Qeverinë e Kosovës, Parlamentin dhe opozitën një ndër prioritetet pa alternativë duhet të mbetet shtrirja e sovranitetit shtetëror në gjithë vendin. E në këtë pikë, përkundër dallimeve politike duhet të jemi të përbashkuar dhe të flasim me një zë. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i ka edhe 6 minuta, ndërsa janë të lajmëruar edhe 6, nga 1 minutë – 6 minuta. Sipas radhës, tash s'po dua ta bëj renditjen qysh e kam bërë më herët, por sipas radhës Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIAZI IDRIZI: I nderuari kryetar,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar deputetë,

E drejta e Kosovës për liri dhe pavarësi më në fund ka fituar, por problemet, pengesat për ta ndërtuar një shtet funksional dhe të barabartë për të gjithë qytetarët tanë janë ende të shumta, pengesat na dalin edhe më të mëdha, e herë më të vogla, varësisht si iu qasemi dhe varësisht si e ndërtojmë partneritetin tonë shtetëror me miqtë, me aleatët dhe me faktorin ndërkombëtar, gjithherë duke u bazuar në vlerat civilizuese, për një tolerancë dhe një diversitet që në bërthamën e tij ka të drejtat elementare të njeriut, si kolektivitet, por edhe si individ.

Sikur ne të mos pranonim këto vlera universale, ndihma e faktorit ndërkombëtar nuk do të ishte kjo që është sot. Faktori ndërkombëtar nuk po thotë që ne nuk i kemi përmbushur të drejtat dhe kompetencat e komuniteteve pakicë në Kosovë dhe nuk gjendemi para një presioni të tillë. Përkundrazi, atyre ua kemi përmbushur ato dhe ua kemi njohur të gjitha të drejtat.

Nëse mbështetësit e pavarësisë së Kosovës kanë thënë se Kosova është rast i veçantë në të drejtën ndërkombëtare dhe nuk mund të merret si precedencë për një konflikt tjetër të pazgjidhur në botë, Kosova është rast i veçantë në botë edhe për sa u takon të drejtave të komuniteteve pakicë që jetojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës.

Duke i pas parasysh të gjitha këto, ne mund të ndjehemi komod me veten tonë në botën civilizuese, e po ashtu edhe me faktorin politik ndërkombëtar.

Të nderuar vendimmarrës, edhe problemet që janë evidente në veri të Kosovës ne duhet t'i shohim në këtë kontekst dhe t'i qasemi zgjidhjes së tyre vetëm me dialog dhe duke iu mundësuar secilit komunitet që jeton në Kosovë që të ndjehet mirë, së pari me veten e tij, edhe me shtetin në të cilin jeton.

Për shkak të kësaj politike parimore që po zbatohet në veri të vendit, Qeveria e Kosovës nuk po përballlet me presionin e faktorit ndërkombëtar, por përkundrazi po përkrahet, sepse me veprimet e saj nuk ka asnjë element që mund të konsiderohet si shkelje apo cenim i të drejtave të komunitetit.

Të nderuar vendimmarrës, intervenimin e Qeverisë së Kosovës në veri për të marrë nën kontroll dy pikat kufitare, në parim e kemi përkrahur të gjithë, por kemi dallime për sa i përket mënyrës se si duhet që edhe në atë pjesë të Kosovës të shtrijmë funksionimin e rendit kushtetues e juridik. Kosova do ta ndërtojë partneritetin e vet të plotë me Uashingtonin dhe me Brukselin.

Po ashtu, ka qasje tjera në të cilat po thirren po ashtu në një të drejtë ndërkombëtare, të cilën shtetet duhet ta zbatojnë për ta ushtruar në gjithë territorin e vet pushtetin. Por, para se të thirremi në këtë të drejtë ndërkombëtare, ne duhet t'i analizojmë përparësitë dhe pasojat e këtij veprimi.

Kërkesa që Qeveria e Kosovës të marrë vetë përsipër kthimin e rendit kushtetues dhe juridik në veri të vendit, për të mos thënë se është një patriotizëm romantik apo një artikulum populist, përmes të cilit tentohet që të sensibilizohet opinionin publik, mendoj se është opsion i gabuar, i rrezikshëm dhe me pasoja.

Shqiptarëve të Kosovës gjatë gjithë historisë shekullore kurrë nuk iu ka munguar guximi, vullneti a sakrifica për të luftuar dhe për t'i realizuar të drejtat e tyre legjitime. Ju e dini, në kryengritjen e vitit 1912, në numër ka pasur më shumë luftëtarë të lirisë se sa që patëm në kryengritjen e vitit 1998. Rezultati i asaj lufte dihet, po dihen edhe rezultatet e luftës së UÇK-së.

Kosovës nuk i ka munguar kurrë gatishmëria për sakrificë, as nuk i ka munguar artikulum kombëtar dhe veprimi politik, por ky i sotmi është më i miri, e për pasojë edhe aleatët tanë të fuqishëm i kemi me vete.

Kërkesat, madje edhe nëse i marrim retorike, politike janë jo produktive. Barrikadat në veri të Kosovës, Serbia po deklaron haptas se nuk i ka vendosur për ta penguar KFOR-in, por që ta provojë edhe në Kosovë modelin e Kroacisë në rast se strukturat e rendit të Kosovës veprojnë kështu siç po kërkohet nga disa zëra këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë, janë kryer diskutimet. Por, i nderuari deputetë, edhe ata para neve në këtë sallë kur kanë qenë, na patën quajtur "patriotë romantikë". Leni këtë fjalë, mos e përdorni, se realisht po na tingëllon keq në vesh dhe s'po mund ta mbajmë. Pra, keni kujdes! Flisni, por mos imitoni të tjerët, se nuk po dilni mirë, dhe unë

s'po kam qejf që ju s'po dilni mirë. Radha është për 5 minutat përfundimtar të kryeministrit. Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emrin tim dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës t'ju falënderoj për diskutimet tuaja korrekte, t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj për Qeverinë e Republikës së Kosovës, për hapat e Qeverisë që ka ndërmarrë dhe që do t'i ndërmerr edhe në të ardhmen për koordinimin e ngushtë të Qeverisë së Republikës së Kosovës me gjithë faktorët relevantë ndërkombëtarë, por në të njëjtën kohë dëshiroj të sqaroj, duke potencuar se Kosova pas 12 vitesh ka filluar një ndryshim të madh në verën e këtij viti, konkretisht me datën 25 korrik, ndryshim ky pozitiv dhe ju secili, të nderuar deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës, duhet të mendoni edhe për zhvillimet globale, kur e gjithë bota dhe lidershpi botëror është i fokusuar në tejkalimin e krizës ekonomike dhe financiare botërore, është i fokusuar në pranverën arabe, për zhvillimet atje, por edhe në krizën e euros, dhe me këtë angazhim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me autoritetet tjera ndërkombëtare kemi arritur të rifokusojmë vëmendjen e qendrave vendimmarrëse botërore përsëri për Republikën e Kosovës.

Prandaj, më lejoni edhe një herë t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj për Qeverinë e Kosovës, t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Kosovës për besimin e tyre dhe ky është sukses i përbashkët i gjithë neve, është sukses i shtetit të Kosovës, është sukses i gjithë qytetarëve të vendit.

Kosova në këto 12 vite ka pasur 3 zhvillime të suksesit të përbashkët si qytetarë dhe politikë, çlirimin e vendit në qershor të vitit 1999, shpalljen e pavarësisë, por edhe fillimin e ndryshimeve të mëdha në veri më 25 korrik.

Të gjitha këto angazhime i kemi bërë bashkërisht dhe pikërisht falë unitetit tonë politik dhe qytetar kemi pasur sukses, falë koordinimit të plotë të institucioneve të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n, ndërsa sot gjithashtu ky bashkëpunim është shumë i ngushtë dhe do të vazhdohet edhe në të ardhmen.

Këtu u përmendën dy-tri çështje të cilat, si do që të jetë, do t'u mbetsha borxh juve si deputetë, të nderuar, për t'i sqaruar, por para se gjithash opinionit publik kosovar.

Vendimi i 25 korrikut ka qenë vendim autonom, sovran, i drejtë, i domosdoshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ata që dëshirojnë ta personalizojnë, edhe le ta personalizojnë. E ritheksoj edhe një herë, unë udhëheq Qeverinë e Republikës së Kosovës. Dhe, të thuhet se veriu i Mitrovicës është më keq se para 25 korrikut, është sikur të thuhet se Kosova është më keq se para çlirimit të Kosovës, është më keq se para 10 qershorit 1999, është sikur të thuhet se Kosova është më keq se sa pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Unë e di se pretenduesit e së vërtetës dhe patriotizmit, pretenduesit pronarë, për t'u paraqitur si pronarë të së vërtetës dhe patriotizmit në Kosovë apo individë, edhe me çlirimin e Kosovës theksuan se kjo nuk është liria që na duhej neve. Kjo nuk është liria e plotë, se nuk arritëm veç vetëm ta çlirojmë vendin. Po këtu qëndron edhe madhështia që e gjithë bota na përkrahu. Edhe kur u shpall pavarësia, kishte individë të zemëruar, herë ishin në politikë, herë jashtë politikës. Por, vullneti i qytetarëve të Kosovës ishte i qartë, çlirimi i vendit dhe për Kosovën dhe popullin e Kosovës, edhe për çlirimin e vendit, edhe për shpalljen e pavarësisë kishte shpresë, optimizëm, besim në të ardhmen e sigurt, prandaj edhe 25 korriku ishte data e ndryshimit të madh për të ardhmen e sigurt të vendit tonë, për garantimin dhe mbrojtjen e integritetit territorial të Republikës së Kosovës dhe forcimit të sovranitetit. Mbrojtja e integritetit territorial të Republikës së Kosovës dhe forcimi i sovranitetit arrihet vetëm me rend e ligj dhe me përgjegjësi shtetërore e jo duke kërcënuar, ushtruar dhunë apo plaçkitur ndaj shoferëve apo mallra të transportuar.

Sepse, u dëgjua edhe këtu, çështja e policëve. Unë do t'i kryej përgjegjësitë e mia të plota në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe obligimet ndërkombëtare. Ata që pretendojnë për t'u konfrontuar edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe me Bashkimin Evropian, edhe me NATO-n, ata nuk janë as partnerë të mi politikë sot, nuk kanë qenë as dje, e nuk do të jenë as në të ardhmen, por ata edhe nuk janë vetë vullneti i qytetarëve të Republikës së Kosovës. Qytetarët e Republikës së Kosovës janë përcaktuar për integrimin në NATO dhe në Bashkim Evropian dhe jo për izolim, jo për konfrontim me botën perëndimore. Prandaj, unë ju ftoj të gjithëve që të punojmë maksimalisht bashkërisht në rrugën tonë të përbashkët për t'u integruar sa më shpejt në NATO dhe Bashkim Evropian, ndërsa sa i përket policëve të Kosovës, dëshiroj të theksoj se që nga dita që e udhëheq unë Qeverinë e Republikës së Kosovës kemi arritur t'i rrisim pagat për 70%. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Sa për informim, kryeministri merr nga koha e pozitës dhe në dispozicion i ka pasur 14 minuta dhe nuk i ka shfrytëzuar as 10 minuta. Do të thotë, po përgjigjem sipas reagimit të një pjese të opozitës. Tani fjalën e ka sponzoruesi i mocionit "Vetëvendosja", deputeti Gauk Konjufca e ka fjalën, 5 minuta!

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të them të drejtën, në fillim prita diskutime më përmbajtjesore dhe më të thella politika e me argumente më të shumta, por kur ke në Parlament edhe deputetë siç është, për shembull, zoti Bekim Haxhiu, natyrisht se gjysma e interpelancës shkon duke e ledhatuar kryeministrin dhe kjo nuk është për t'u çuditur.

Mirëpo, këtu megjithatë u bënë të qarta shumica e pozicioneve të subjekteve politike, kush ku është. Mendoj që Partia në pushtet tashmë na tregoi qartë që është për të vazhduar me avazin e vjetër dhe për të shikuar se cilat barrikada po i heq KFOR-i!

Lidhja Demokratike e Kosovës, mendoj që si gjithmonë, as mish as peshk!

Partia SLS dhe Lëvizja për bashkim, mendoj që e kanë shumë të kollajshme zgjidhjen e veriut të Kosovës, se më lehtë është për t'ia dhënë Serbisë!

AKR-ja mendoj që është më kritike, mirëpo, megjithatë aty te Qeveria, sepse janë koalicion, kurse AAK-ja ka qenë, siç duket, dukshëm më kritike lidhur me Qeverinë.

Megjithatë, më lejoni që të përfundoj që zyrtarët qeveritarë shpeshherë e kanë përsëritur se misioni i Qeverisë më 25 korrik ishte ky: që të ndërhyhet simbolikisht, e pastaj mekanizmat ushtarakë, policorë e civilë ndërkombëtarë të merren me gjendjen e krijuar atje.

Deri tash zyrtarët qeveritarë kanë thënë se ndërhyrja ishte simbolike. Po pra, simbolike, sepse këta njerëz kanë ndërtuar shtet simbolik dhe paskan shpallë pavarësi simbolike. Ata shpalljen e pavarësisë e kanë për imazh dhe përmendje në histori, e jo për shtetndërtim.

Kjo strategji qeveritare nuk është asgjë tjetër veçse krijimi i një mjedisi të tendosur, ashtu që veriu të përfundojë si çështje në negociata.

Qeveria veriu në negociata nuk do të mund ta dërgonte pa e improvizuar këtë tendosje të situatës. Një gjë është shumë e qartë – Qeveria ka ndërhyrë vetëm aq sa është e nevojshme që veriu të bëhet çështje e negociatave.

Lidhur me këtë interpretim të Qeverisë, pra se Qeveria paska ndërhyrë që më pastaj faktorët ndërkombëtarë të kryejnë punën, mendoj që duhet të kritikohet në tri aspekte themelore:

E para, se deklaratat e tilla me të vërtetë nuk i kanë hije një Qeverie të një shteti sovran, që do të thotë se dikush tjetër duhet të na i kryej punët.

E dyta, se edhe kryeministri bile u ankua, që institucionet atje të cilat po merren me punën, janë neutrale ndaj statusit, por nuk na tregoi që ky vetë i ka ftuar këto misione neutrale ndaj statusit.

Dhe, e treta, që me një politikë të tillë pasive, veriu rrezikon të përfundojë në negociata.

Përveç kësaj, Kryeministri Thaçi po shpreh një gatishmëri për t'u takuar me presidentin Tadiq. Ata do t'i shtrëngojnë duart dhe do të buzëqeshin si dy udhëheqës, vendet e të cilëve nuk kanë asnjë problem me njëri-tjetrin.

Por, kjo buzëqeshje nuk do të jetë simetrike. Buzëqeshja e Tadiqit do ta maskojë projektin hegjemonik serb, kurse buzëqeshja e Thaçit do ta maskojë dorëzimin e Qeverisë në veri. Brukseli do të thotë bravo. Serbia do ta marrë integrimin evropian, kurse ne rrezikojmë të mbesim me probleme të njëjta, ndarje territoriale, korrupsion, varfëri, papunësi dhe larg integriteteve evropiane.

Hashim Thaçi me siguri që do ta dërgojë Serbinë ekspansioniste dhe antishqiptare në BE, por nuk jam i sigurt që këtë do ta bëjë me Kosovën. Mënyra e tij e qeverisjes jodemokratike dhe korruptive është bërë pengesë serioze për rrugëtimin tonë në BE.

Prandaj, deputetë të Kuvendit të Kosovës, unë kërkoj nga ju që t'i mbështetni pikat e propozuara të mocionit tonë.

Votimi i këtyre katër pikave do të ishte kontribut i nevojshëm institucional në funksion të parandalimit të planit të Serbisë për ta sjellë veriun e shtetit tonë në tavolinën e negociatave, prej të cilave nuk do të kemi çka të fitojmë, por do të kemi shumëçka të humbim.

Shpresoj në ndërgjegjen tuaj, në përgjegjësinë tuaj përpara qytetarëve, atdhedashurinë tuaj, si dhe vullnetin tuaj të lirë.

Pikat e mocionit janë katra:

1. Të ndërpriten bisedimet me Serbinë dhe të shpallen të pa vlefshme dhe të pa zbatueshme secila marrëveshje me Serbinë, para se Serbia të na njeh;
2. Qeveria t'i dërgojë forcat policore në veri për të garantuar integritet territorial dhe mbrojtje të qytetarëve të shtetit të Kosovës;
3. Që institucionet e rendit të Republikës së Kosovës të angazhohen në heqjen e barrikadave dhe pengesave të tjera, dhe jo vetëm të shikojnë, dhe
4. Që Qeveria t'ua presë burimin financiar strukturave të paligjshme dhe kriminale të shtetit të Serbisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, unë po pajtohem që Glauku nuk ka pasur të drejtë për këtë pjesë të 5 minutave t'i cilësojë partitë politike.

Po, ju e dini që sipas nenit 44, paragrafi 7, 5 minutat e fundit e mbyllin debatin. Ju lutem, mbyllet debati. Kështu e kemi rregullën.

(Ndërhyrje)

Urdhëro! Po e tejkalojmë, por po kërkojmë që në raste të tilla mos të kalohet në debat. Replikë, dy minuta. Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit, Është e vërtetë që Rregullorja thotë strikt ashtu si thoni ju. Veç është e vërtetë që ajo rregullore nuk po zbatohet në këtë foltore.

Unë nuk dua të komentoj asnjë politikë të asnjë partie këtu, as të grupeve parlamentare dhe s'e bëj kurrë.

Unë mendoj se ata që notojnë në këtë formë, e kanë gabim. Pse e kanë gabim? Sepse e folmja e tillë, sidomos kur bisedohet për çështje të mëdha për Kosovën, nuk është as etikë, as politikë. Kaq.

Sa për punën e mësimave, të mos mësimave, të gjithë të edukuarit e ri e kanë ambicien që i thonë babës: “hajde babë, t’i kallëzoj megjët e arave”, thonë popullorçe, dhe unë e përfundoj këtu.

KRYETARI: Faleminderit! Po, urdhëro Hajredin, merre fjalën dy minuta! Po, ju lutem, lexojeni Rregulloren dhe pastaj kërkon fjalën! Kush nuk di të lexojë, mos të vjen në Kuvend!

ZËVENDËSKRYEMNISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar anëtarë të Kuvendit, të Qeverisë,

Është e vërtetë, por besoj që edhe kryetari i Kuvendit duhet t’ua ndalë fjalën kur dilet jashtë rendit të ditës dhe atëherë ne s’do të reagonim!

Por, ajo çka mund të them, Glauk, pate kohë më herët për të folur për debat dhe të bësh replika. S’e kemi ndërmend të bëjmë politikë kamikazësh. Dhe, tek e fundit, vendi ynë nuk do të bëjë politikë kamikazësh. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Jo, fjalën nuk do t’ia jap më kurrkujt, por po kërkoj nga të gjithë që e morën fjalën, se e kemi një pikë të rendit të ditës dhe t’i përmbahemi pikës, mos t’i ngacmojmë të tjerët. Ky reagim ishte për shkak se në përfundimin e këtij debati për këtë mocion, deputeti Glauk Konjufca vërtet i kaloi disa kufij të lejueshëm dhe e kaloi pikën e rendit të ditës.

Ju lutem! E kemi pra mocionin që e lexoi pak më parë parashtuesi. Ju e dini si keni debatuar dhe ne hyjmë në procedurën e votimit.

Në sallë kemi 88 deputetë!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 17 vota “për”, 54 “kundër”, asnjë “abstenim”, Kuvendi nuk miratoi mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”.
Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës